



“Arsimi ynë do të ecë i sigurt në rrugën e arritjes së standardeve evropiane të cilësisë”

M. Tafaj

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Z. Myqerem Tafaj, uron nxënësit, mësuesit dhe prindërit për vitin e ri shkollor 2010-2011

Të dashur nxënës,

Ju uroj një vit të mbarë dhe të suksesshëm shkollor!

Urimi i parë u drejtohet më shumë se 42000 nxënësve që ulen për herë të parë në bankat e shkollës dhe nisin rrugën e gjatë dhe të bukur të dijes.

Ju premtoj se këtë vit të ri shkollor ju do të gjeni një shkollë më miqësore, më të afërt e më të dashur, mësimdhënie më cilësore. Në shkollë ju do të gjeni një familje të dytë, në të cilën do të rriteni, do të mësoni, do të edukoheni si qytetarë të denjë dhe do të arrini rezultatet që dëshironi.

Është shumë e rëndësishme që secili nga ju të besojë fort se mund të arrijë rezultatet që pret, sepse gjithkush ka jo vetëm aftësitë e përgjithshme, por edhe prirje në një ose më shumë lëndë, që mund të jenë letërsia, matematika, gjuha e huaj, kompjuteri, sporti, arti, apo ndonjë fushë tjetër.

Më lejoni që një urim të veçantë t’u drejtoj atyre që në këtë vit shkollor do të përgatiten për studimet universitare, e kam fjalën për maturantët.

Të dashur maturantë,

Ju do të përfundoni shkollën e mesme me Diplomë të Gjimnazit, çka përbën një standard të ri cilësor afër atij evropian. Kjo krijon edhe bazën për përmbyshjen e kriterëve të njëjta në pranimet në arsimin e lartë publik dhe privat, me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme.

vijon në faqen 2

REFORMA DHE ARSIMI

Reforma e reformave në arsimin parauniversitar

Lista e reformave në fushën e arsimit gjatë periudhës postdiktatoriale mund të jetë nga më të gjatat dhe me një shpejtësi mamamendëse. Janë bërë reforma të suksesshme, që kanë përmirësuar dukshëm legjislacionin, kurrikulat, strukturën, infrastrukturën, programet dhe metodologjinë për një arsimim më cilësor parauniversitar.

MESUESI DHE NXENESI

Hartimi i planit mësimor

Strukturat e formatit të planifikimit mësimor janë të ndryshme për shkak të ndikimit të një morie faktorësh dhe përbëjnë atë që quhet “liria akademike e mësuesit”. Por cilido qoftë formati i zgjedhur, struktura e tij ka një vijë logjike.

SHKOLLA DHE KOMUNITETI

Mbi menaxhimin në bazë shkolle

Ndër shumë strategji që janë duke u zbatuar në vende të ndryshme të botës, e njohur është ajo e Menaxhimit në Bazë Shkolle. Thelbi i saj konsiston në decentralizimin e vendimmarrjes në arsim, nëpërmjet rritjes së përfshirjes së prindërve dhe të komunitetit në veprimtarinë e shkollave.



Në ditën e parë të shkollës, gjatë përrurimit të shkollës 9-vjeçare “Pal Zefi”, Durrës

Përmbajtja: faqe

Reforma dhe Arsimit	
Konferenca “Reforma Financiare e Arsimit të Lartë”	3
“Reforma Financiare e Arsimit të Lartë”	4-5
Reforma e reformave në arsimin parauniversitar	6-7
Mendime rreth kurrikulës së re të gjimnazit	8-10
Mësuesi dhe Nxënësi	
Hartimi i planit mësimor	11-12
Organizimi i mësimin me grupe nxënësish	12-13
Matrica e cilësisë në arsimin profesional	14-15
Vendi ku dëshiroj të jetoj - Kuçova ime	15
Urime në ditën e parë të shkollës!	16-17
Një mësues i mirë	18-19
Traditë dhe Kulturë	
Përdorimi i Kamishibait si mjet didaktik dhe integruar	20-21
Mësuesi vullnetar i vitit 1942 në Kosovë	21
Mësimi plotësues në diasporë	22-23
Shkolla dhe Komuniteti	
Mbi menaxhimin në bazë shkollë	23-24
UDHËZIM	
Për mbarëvajtjen e punës mësimore-edukative në sistemin e arsimit parauniversitar në vitin shkollor	25-30
KONKURS	
Mësuesi Model	32

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Z. Myqerem Tafaj, uron nxënësit, mësuesit dhe prindërit për vitin e ri shkollor 2010-2011

Të dashur mësues,

Ju falënderoj për përkushtimin dhe punën e palodhur që bëni në përmbushjen e misionit tuaj fisnik. Një falënderim dhe mirënjohje u takon të gjithë brezave të mësuesve që kanë dhënë ndihmesën e tyre dhe që kanë lënë gjurmë në zhvillimin e arsimit tonë kombëtar.

Politika e Qeverisë për rritjen sistematike të pagave ka bërë që ju të keni sot një status shumë më të mirë dhe te merituar, një status dinjitoz jo vetëm në piramidën e sektorit tonë publik, por edhe në raport me kolegët tuaj në rajon. Kjo është një arritje shumë e madhe, sepse e ka bërë profesionin e mësuesit ndër më të preferuarit, çka ka nxitur konkurrencën dhe rritjen e shkallës së kualifikimit. Kjo garë duhet të vazhdojë.

Të nderuar prindër,

Ju nuk jeni thjesht nëna e baballarë të shkollarëve, por jeni partnerët më të rëndësishëm të shkollave tona. Unë ju ftoj që ta thellojmë më tej këtë bashkëpunim.

Të dashur nxënës, mësues dhe prindër,

Shqipëria po zhvillohet me ritme të shpejta në të gjitha fushat. Arsimit duhet t'i paraprijë këtij zhvillimi, sepse është faktori kyç që përcakton se sa shpejt Shqipëria do të zhvillohet më tej, i mbështetur në ekonominë dhe shoqërinë e dijes së këtij shekulli.

Prandaj, sistemi ynë arsimor përballet me sfida shumë të mëdha dhe të vështira, por, midis tyre, unë dëshiroj të nënvizoj atë kryesoren: Arsim cilësor për të gjithë.

CILËSIA përcakton nëse ju, të dashur nxënës, do të arsimoheni në një nivel të krahasueshëm me bashkëmoshatarët tuaj evropianë.

Cilësia nënkupton: Përbajtje e mbështetur fort në traditën e arsimit tonë kombëtar dhe zhvillimet e sotme ndërkombëtare. Reforma e kurrikulës do të thellohet në arsimin bazë dhe atë profesional.

Kushte normale për mësimdhënie në çdo shkollë. Vazhdon ndërtimi dhe rindërtimi i shkollave në të gjithë vendin. Deri në fund të vitit 2010 përfundojnë 50 shkolla të reja. Ka filluar ndërtimi dhe rikonstrukcioni i 33 shkollave të tjera me parametra të mirëfillta evropianë.

Mësimdhënës që e duan profesionin e bukur të mësuesit dhe janë të kualifikuar për të mësuar nxënës me pasion e interesa të ndryshme që rriten në kohën e internetit. Reforma e nisur e studimeve në mësuesi i shërben pikërisht përgatitjes së gjeneratave të ardhshme të mësuesve sipas standardeve të përparuar.

Tekste të një cilësie të lartë dhe sa më të thjeshta për nxënësit.

Reforma e Altertektit e tregoi veten se mund të nxisë, jo vetëm rritjen e cilësisë, por edhe tregun e lirë të librit.

Laboratorë dhe mjete didaktike që e bëjnë të nxënësit tërheqës dhe të thjeshtë. Në sistemin e arsimit bazë dhe atë të mesëm këtë vit shtohen rreth 350 laboratorë të rinj.

Përdorim të gjerë të teknologjisë së informacionit në mësimdhënie, e cila, së bashku me zotërimin e gjuhëve të huaja, janë aftësi bazë që duhet te përvetësojë çdo nxënës dhe mësues. Këtë vit pajisen me laboratorin e dytë të kompjuterave 150 shkolla të mesme dhe 9-vjeçare. Pra ne kemi nisur fazën e dytë, të pajisjes së shkollave me laboratorët e dytë të kompjuterave.

Por arsimit cilësor duhet te jetë për të gjithë.

Objektivi ynë mbetet:

- çdo 5- vjeçar në kopsht,

- çdo 15-16- vjeçar të përfundojë arsimin e detyruar, pra atë 9- vjeçar, dhe të ketë mundësi të vijoje arsimin e mesëm, të përgjithshëm ose atë profesional.

Me kënaqësi mund t'u deklaroj se këtë vit është rritur regjistrimi i fëmijëve në kopshtet e fshatit.

Regjistrimi në shkollën e mesme deri tani ka arritur në 90.6 % të nxënësve që përfunduan arsimin e detyruar. Në arsimin profesional, krahasuar me vitin e kaluar, janë regjistruar deri tani 11 % më shumë nxënës në vitin e parë. Rreth 600 nxënës janë regjistruar në degën e IT-së, që përbën rreth 10 % të numrit total të nxënësve të regjistruar në vitin e parë të arsimit profesional.

Të gjitha sfidat me të cilat ballafaqohet sistemi ynë arsimor janë plotësisht të përballueshme përmes një bashkëpunimi të ngushtë të të gjithë aktorëve: mësuesit dhe punonjësit e arsimit, nxënësit, njësitë e qeverisjes vendore, prindërit dhe komuniteti.

Në përfundim, dëshiroj t'ju siguroj se, mësuesit tanë të përkushtuar dhe të gjithë punonjësit e sistemit të arsimit, nga Ministria deri në shkollën më të largët të vendit, do të punojnë që arsimit ynë të ecë i sigurt në rrugën e arritjes së standardeve evropiane të cilësisë, sepse vetëm në këtë mënyrë ai mund t'i paraprijë Shqipërisë Evropiane.



Konferenca “Reforma Financiare e Arsimit të Lartë”

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, organizoi sot Konferencën “Reforma Financiare e Arsimit të Lartë”, me pjesëmarrjen e Kryeministrit të Shqipërisë, Z. Sali Berisha.

Kjo konferencë paraqiti parimet kryesore të modelit të ri të financimit të Arsimit të Lartë, publik dhe privat, duke çelur debatin publik mbi këtë platformë.

Në prezantimin e tij, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Z. Myqerem Tafaj, e cilësoi sistemin e financimit të Arsimit të Lartë si reformën më të thellë pas Kartës së Bolonjës.

Parimi bazë i Reformës së financimit të Arsimit të Lartë do të jetë: Fondet publike ndjekin studentin në shkollat e larta publike dhe private që plotësojnë standardin e cilësisë.

Financimi publik i AL përfshin:

1. Financimi i AL me mekanizëm shpërndarjeje të fondeve publike - Studentin
2. Financimi i zhvillimit strategjik të IAL-ve
3. Financimi i kërkimit shkencor

Kjo skemë financimi krijon hapësirën për të tërhequr në arsimin e lartë edhe financimin jopublik.

Kriteret e përfshirjes së një universiteti në këtë skemë do të jenë dy. Universitetet publike, por edhe universitetet private jofitimprurëse.

Së dyti, Universiteti duhet të plotësojë standardin e cilësisë së pranuar për Shqipërinë, standard ky i njëjtë me standardet evropiane.

Studentët që kanë kaluar me sukses Maturën Shtetërore dhe kanë arritur një prag të caktuar të pikëve, i cili do të vendoset në bashkëpunim me botën akademike. Përmes kësaj skeme do të financohen studimet e nivelit Bachelor dhe studimet post-sekondare dyvjeçare. Mundësi financimi do të krijohen edhe për studimet e nivelit të dytë e të tretë për programe studimi në degët më të rëndësishme të vendit.

Fondi për zhvillimin strategjik të universiteteve është një me-

kanizëm financimi konkurrues që do të destinohet për zhvillimin institucional, përfshi këtu edhe përshtatjen institucionale, investimet për infrastrukturën e universiteteve publike, hapjen e programeve apo zhvillimin në universitetet rajonale ose iniciativat e tjera në përputhje me politikën arsimore kombëtare. Kjo reformë kërkon edhe një strukturë të menaxhimit dhe qeverisjes së institucioneve të arsimit të lartë. Institucionet publike do të fitojnë autonomi maksimale sipas modeleve më të mira evropiane, por kjo autonomi nënkupton një përmirësim të menaxhimit administrativ, financiar dhe të politi-



kave të zhvillimit të burimeve njerëzore në këto institucione. Prioriteti ynë në këtë reformë do të jetë së pari siguri e cilësisë. Hallka më e rëndësishme mbetet diskutimi i gjerë publik. Ne sot vetëm shpallim fillimin e këtij diskutimi. Ky diskutim publik do të vijojë me botën akademike, me studentët, gjimnazistët, me sektorin privat që investon në arsimin e lartë dhe me bankat.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin edhe Ministri i Financave, Z. Ridvan Bode, drejtues të universiteteve publike dhe private të vendit, ekspertë të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor dhe përfaqësues të studentëve.

Konferencën e përshëndeti Kryeministri i Shqipërisë Z. Sali Berisha

Kryeministri theksoi se vendosja e një mekanizmi të ri financiar në arsimin e lartë, garanton të gjitha mundësitë për një liri të vërtetë akademi, dhe rritje të cilësisë.

- Kryeministri garantoj se qeveria është e vendosur t’u japë universiteteve me ligj dhe me të gjitha mënyrat autonominë më të madhe të mundshme që ekziston në vendet më të zhvilluara. Kryeministri nënvizoi ndër të tjera, se kjo Reformë dhe ky diskutim duhet t’i japë arsimit të lartë, së pari një autonomi të plotë. **“Ju garantoj se qeveria është e vendosur t’u japë ju me ligj dhe me të gjitha mënyrat autonominë më të madhe, të mundshme që ekziston në vendet më të zhvilluara. Liria akademike nuk mund të zhvillohet nuk mund të ndërtohet pa një autonomi të plotë.”**, tha Kryeministri.

Duke theksuar se autonomia nga qeveria është jetike, Kryeministri vlerësoi se po kaq jetike, për universitetet është autonomia e njësisë të tyre, e fakulteteve, kolegjeve, etj. “Një dimension të ri në këtë autonomi, ne duhet t’i japim lirisë akademike në vend, u shpreh kryeministri.

Kryeministri theksoi ndër të tjera, se vendosja e një mekanizmi të ri financiar në arsimin e lartë, garanton të gjitha mundësitë për një liri të vërtetë akademike dhe rritje të cilësisë.

Ne kemi nevojë jetike të zhvillojmë të gjitha kapacitetet në fushën e arsimit të lartë si kushti i të gjitha kushteve për të for-

mësuar me përgjegjësi të madhe të ardhmen tonë. Asgjë, asnjë proces tjetër për një vend të lirë, nuk përcakton më shumë të ardhmen, se kjo fushë, pra Arsimi i Lartë.

Kjo reformë dhe ky diskutim duhet t’i japë arsimit të lartë, së pari, një autonomi të plotë. Askush nuk duhet të mendojë se universitet mund të lumturohen nga qeveritë. E vetmja mënyrë e lumturimit të tyre nga qeveritë është që ato të kenë autonominë më të madhe nga qeveritë dhe unë ju garantoj se qeveria është e vendosur t’u japë ju me ligj dhe me të gjitha mënyrat, autonominë më të madhe, të mundshme, që ekziston në vendet më të zhvilluara. Liria akademike nuk mund të zhvillohet, nuk mund të ndërtohet pa një autonomi të plotë. Natyrisht, në këtë kontekst është i domosdoshëm të zhvillohet siç duhet ky koncept. Në rast se autonomia nga qeveria është jetike, po kaq jetike nga universitet është autonomia e njësisë të tyre, të fakulteteve e kolegjeve, pra një dimension të ri, në këtë autonomi, ne duhet t’i japim lirisë akademike në vend. Reformat janë guxim. Nuk duhet të harrojmë se për definicion bota akademike ka dhe konservatorizmin e saj. Misionin e ka tjetër, e ka patur, ndaj dhe le të punojmë së bashku që siç kemi arritur një ndryshim të lartë sasior, por edhe cilësor, tani të përqendrohemi me të gjitha energjitë tona, për një cilësi të re, më të lartë në arsimin universitar të Shqipërisë.

Reforma Financiare e Arsimit të Lartë

Mimoza AGOLLI

Këshilltare pranë Ministrit të Arsimit për Reformën Financiare

I. Konteksti i reformës dhe objektivat kryesore të saj

Reforma e Financiare në Arsimin e Lartë, është një nga reformat më radikale të ndërmarra në arsimin e lartë që do të ketë ndikime të ndjeshme në vetë konceptin e universitetit duke bërë studentin dhe cilësinë e arsimit të lartë faktorët bazë të zhvillimit të tij.

Kjo reformë u përgjigjet sfidave dhe zhvillimit të shpejtë të këtij sektori arsimor si nga ana e kërkesës ashtu dhe ajo e ofertës. Liberalizimi i aksesit në arsimin e lartë ka rritur ndjeshëm numrin e studentëve, ndërkohë që kërkesa e lartë për arsimim u shoqërua me rritjen e kapaciteteve në arsimin publik dhe rritjen e operatorëve privatë (universitetet private).

Tendencat e zhvillimit të arsimit të lartë në botë, ku koncepti tradicional i universitetit ka evoluar dhe partneriteti publik-privat është një nga mënyrat më të përhapura të zhvillimit të universiteteve në qendra moderne të akumulimit dhe shkëmbimit të dijes është gjithashtu një faktor i rëndësishëm në nxitjen e kësaj reforme.

Iniciativa e reformimit të mënyrës së financimit të universiteteve synon të forcojë rolin e tij, faktor kryesor i zhvillimit dhe prosperitetit të vendit, të rrisë aksesin e të rinjve shqiptarë në universitete dhe mbi të gjitha kjo reformë synon të bëhet faktor nxitës i rritjes së cilësisë së arsimit të lartë. Duke stimuluar partneritetin publik-privat synohet të forcohet lidhja e universiteteve me tregun e punës si dhe një mobilizim më i madh i burimeve kombëtare në mbështetje të arsimit të lartë.

II. Parimi bazë i reformës dhe instrumentat kryesore të skemës së financimit

Parimi bazë i reformës financiare në arsimin e lartë është i përkufizuar thjesht si më poshtë: “Fondet publike “ndjekin studentin” në shkollat e larta që ofrojnë arsimim mbi një nivel cilësor të pranuar për Shqipërinë”.

Një parim i tillë do të thotë se mekanizmi i alokimit të fondëve publike tek universitetet do të jetë studentin, i cili në varësi të fushës së studimit që do të ndjekë si dhe të universitetit që do të përzgjedhë do të përfitojë financim publik. Këtë financim ai e mbarë me vete dhe ia kalon universitetit në momentin e regjistrimit. Kështu tërësia e fondeve publike që përfiton universiteti është shumica e financimit që mbarë çdo student. Ky financim mund të jetë në formën e një burse të plotë studimi, formën e “pagesës për student” apo në formën e tarifës së shkollimit.

II.1 Financimi me bazë studentin.

Ky bllok financimi për universitetet do të jetë baza kryesore e burimeve financiare publike për universitete dhe do të ketë tre elementë bazë: (i) financim për student (ii) tarifën e studimit (kredidhënien) si dhe (iii) bursa të plota studimi.

Universitetet që do të përfitojnë nga këto fonde do të jenë ato publike si dhe universitetet private të cilat janë të regjistruara si aktivitete jo-fitimprurëse. Kriteri i dytë që do duhet të plotësojnë universitetet (publike dhe private) do të jetë ai i cilësisë.




Studentët që përfitojnë financimin publik do të kuotohen në bazë të rezultateve të maturës shtetërore dhe kapaciteteve të pranimit në universitete. Financimi publik për student do të jetë vetëm për studentët e ciklit të parë të studimeve (bachelor) si dhe për ata që ndjekin studime të larta (post-sekondare) profesionale.

Vlera e financimit që përfiton çdo student do të përcaktohet nga kostoja e vlerësuar e studimeve të tij, fusha e studimeve që ai ndjek, rajoni në të cilin ai ndjek studimet si dhe nga politikat për zhvillimin e arsimit të lartë. Vlera e financimit që do të përfitojë studenti do të jetë e përafëruar me koston e vlerësuar të studimeve të tij, por do të ketë diferencime në shkallën e mbulimit të koston për fusha studimi të caktuara për të balancuar ndonjë efekt negativ që ky lloj financimi mund të ketë për një degë studimi me natyrë të vecantë p.sh veterinaria. Kjo degë nuk është një nga më të preferuarat për studentët, është e shtrenjtë dhe tregu i punës është i varfër. Gjithsesi ngelet një degë për të cilën ekonomia kombëtare apo ajo e rajoneve të caktuara ka nevojë dhe si rezultat financimi për student mund të jetë i diferencuar. Diferencimi në financim mund të jetë rezultat edhe i politikave afatshkurtra ose afatmesme në arsimin e lartë, tregun e punës dhe akumulimit të

burimeve njerëzore në shkallë kombëtare. Nëse në nivel kombëtar (apo edhe rajonal) do të ishte me interes trainimi i më shumë specialistëve në fushat inxhinierike, studentët do të inkurajohen nëpërmjet shkollës më të lartë të financimit të zgjedhin këtë fushë studimi. Diferencimi i nivelit të financimit në bazë rajoni bëhet për vetë diferencën në kostot e ofrimit të shërbimit midis rajoneve.

Figura 1. Skema e financimit të IAL me bazë Studentin



Studentët me të mirë që vijnë nga matura shtetërore, studentët në degë të strategjisë kombëtare si dhe studentët e ekselencës (në nivelin e dytë dhe të tretë të studimeve) do të përfitojnë bursa të plota studimi.

Diferencën mes tarifës së shkollimit të shpallur nga universitetet (publike dhe private) me financimin që përfiton çdo student do të paguhet nga vetë studentët. Kjo diferencë do të jetë tarifa reale e shkollimit të tyre, pagesa e së cilës do të mundësohet nëpërmjet një sistemi kredidhënie të butë studentore. Cdo student i regjistruar në universitetet publike apo private do ketë të drejtën të marrë një kredi të tillë, me vlerë maksimale të përcaktuar. Interesat e kësaj kredie do të subvencionohen nga qeveria shqiptare, ndërkohë të rinjtë që vijnë nga familjet në nevojë do të jenë më të favorizuarit në skemën e kredidhënies. Kredia studentore fillon të shlyhet 2-vjet pas përfundimit të studimeve dhe punësimit. Kredidhënia studentore është një formë e partneritetit publik-privat që do të rrisë ndjeshëm financimin në arsimin e lartë. Ky instrument ndihmës në sistem siguron familjet shqiptare **se asnjë nga fëmijët e tyre që ka dëshirë dhe aftësi të studiojë nuk do të ngelet pa shkollim për arsye të kufizimeve ekonomike familjare.**

II.2. Elementë të tjerë të skemës së financimit

Skema e financimit me bazë studentin, do të plotësohet me dy instrumenta ndihmës atë të (i) financimit institucional - Fondi i Zhvillimit Strategjik të Universiteteve si dhe (ii) me financimin e aktiviteteve të kërkimit dhe zhvillimit në universitete (publike dhe private).

Fondi i Zhvillimit Strategjik të Institucioneve të Arsimit të Lartë, do të jetë një mekanizëm financimi bazuar tek kërkesat në formë projektësh zhvillimi të universiteteve. Ky është një mekanizëm financimi konkurrues dhe do të përdoret për të financuar projekte të zhvillimit të infrastrukturës në universitetet publike, projekte të përmirësimit të treguesve të cilësisë në universitetet publike dhe private, hapjen e programeve të reja (ndërdisciplinore, ose të rëndësisë kombëtare) në universitetet publike dhe private, projekte të zhvillimit të universiteteve rajonale në qendra të zhvillimit rajonal apo iniciativa të tjera në përputhje me politikën arsimore kombëtare afatgjata.

Financimi i Aktiviteteve të Kërkimit Shkencor do të realizohet nëpërmjet tre burimeve kryesore. Financimi i aktivitetit

kërkimor fundamental që është i lidhur me mësimdhënien dhe zhvillimin e stafit akademik do të përballohet nga financimi me bazë studentin. Financimi i aktiviteteve të mirëfillta të kërkimit dhe zhvillimit do të financohet nga fondet kombëtare të menaxhuara nga Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) si dhe nga fondet e Kuadrit të Shtatë të BE. Burime financimi të tjera do të jenë ato jo-publike që mbështesin kërkimin shkencor si donatorë të ndryshën apo kontrata tregare shërbimi dhe konsulence që universitetet mund të angazhojnë ekspertizën e tyre. Institutet e Kërkimit Shkencor pranë universiteteve do të financohen nga fondet publike në bazë të performancës së matur të tyre.

Reforma financiare në arsimin e lartë zgjeron ndjeshëm autonominë e universiteteve. Për të siguruar përshtatshmëri dhe efikasitet në kushtet e reja të financimit reformimi i universiteteve - menaxhimit dhe qeverisjes së tyre si dhe sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë mbetet element kyç në këtë platformë reformuese.

Kjo reformë është gjithëpërfshirëse dhe do të kërkojë bashkëpunim të të gjithë grupeve të interesit. Në këtë hapje debati ishin të ftuar të gjithë drejtuesit e Universiteteve publike dhe private në Shqipëri, akademikë dhe njerëz me kontribut në zhvillimin e Arsimit të Lartë dhe kërkimit shkencor, njerëz të njohur të financave publike si dhe përfaqësues të studenteve.



Reforma e reformave në arsimin parauniversitar

Lista e reformave në fushën e arsimit gjatë periudhës postdiktatoriale mund të jetë nga më të gjatat dhe me një shpejtësi marramendëse. Janë bërë reforma të suksesshme, që kanë përmirësuar dukshëm legjislacionin, kurrikulat, strukturën, infrastrukturën, programet dhe metodologjinë për një arsimim më cilësor parauniversitar. Po ashtu janë bërë dhjetëra shkrime, emisione e debate televizive për stadin e arsimit demokratik në vendin tonë. Megjithatë të gjithë kanë anashkaluar, përgatitjen bashkëkohore të mësuesve të rinj, që unë do ta konsideroja reformën e reformave në arsimin tonë, i shpallur përparësi e përparësive në programin e qeverisë demokratike.

Fatmirësisht “thembrën e Akilit” e bëri objekt Konferenca Kombëtare “Reforma e mësuesisë, Formimi Universitar i mësuesve sipas standarteve evropiane”. Fjalët e doktor Berishës “...nuk mund të synojmë orbitë tjetër, përveçse orbitën e vendeve të zhvilluara, të cilat nuk rrinë në vend numëro për të na pritur ne. Ndaj ne duhet të vrapojmë dhe duhet të jemi me nxitim. Rruga më e sigurt është investimi në arsim. Në këtë investim rëndësi kapitale ka përgatitja e mësuesve...” ishin pika mbi “i” për zgjidhjen e ngërçit që pengon trendin evropian të zhvillimit të arsimit. Dihet nga të gjithë sa u përbuz, sa u shfityrua dhe sa u anatemia profesioni i mësuesit me ndryshimin e sistemit. Rinia shkollë, duke e identifikuar shkollën me shtetin diktatorial, i cili e privonte nga shumë dëshira dhe mësuesin me gardianin e shtetit, u ftoh me dritëdhënësin e tij, mësuesin. Kjo bëri që të rinjve t’u zbehej edhe dëshira për profesionin e mësuesit dhe gjatë viteve të tranzicionit, maturantët cilësorë nuk u kthenin as sytë degëve të mësuesisë. Edhe pse disa vjet, në degën matematikë-fizikë, studentët merrnin bursë të plotë, nxënësit cilësorë nuk u afruan dhe këto para i keqpërdorën ata studentë, të cilët nuk fitonin dot konkurset në asnjë degë tjetër. Kur mori start Matura Shtetërore, nga 12 preferenca, që shënoheshin në formularin e përzgjedhjes së degëve sipas meritës dhe preferencës, nxënësit cilësorë nuk e vinin mësuesinë as preferencën e dymbëdhjetë. Edhe sot, kur shumë gjëra kanë ndryshuar, aspirimi i maturantëve për këtë degë është pothuajse i ngrirë. Dhe puna pa pasion e vullnet është punë Sizifi. Për të thënë të vërtetën e Zotit, në degën e mësuesisë nga shkolla e mesme kalon pjesa më e madhe e “mallit” skarco. Mall skarco quaj ata nxënës, që s’kanë marrë dot asnjë pesë me forcat e tyre, filtrimin e të cilit s’ka arritur ta realizojë dot as Matura Shtetërore. Përkundrazi ajo u ka dhënë shanse për të kapërcyer barrierat konkurruese. Dhe të tillë nxënës janë ata të pamotivuarit, që vijnë në shkollë për të kaluar kohën në shoqëri bashkëmoshatarësh, ata që bëjnë të fortin në klasë, në shkollë dhe në sallat e provimeve të MSH, duke u kërcëlluar dhëmbët mësuesve dhe adminis-

Hamit TAKA

Mësues në shkollën e mesme - Sarandë

tratorëve. Këto kontingjente dhe Herkulin ta bëjnë në shkollat e larta, nuk do ta sigurojnë as përgatitjen profesionale, pa lere më etikën e sjelljes së mësuesit bashkëkohor. Të mos harrojmë edhe faktin se këto diploma mjerave, shpesh paramendohen për synime të tjera, si karrierë politike apo karrige pushteti, nga mund t’u thonë “mirupafshim!” halleve... Hallet le t’u mbeten atyre që tharjnë trurin mbi libra dhe djersijnë për të përballuar vështirësitë e shkollës, të punësimit dhe të jetës. Shkurt, ata që marrin karton-diplomën e mësuesisë, sidomos djemtë, punën në arsim e kanë shansin e fundit, në se nuk gjejnë dot mundësi të tjera më të lehta dhe më dobiprurëse. Nuk është se kjo që them unë është diçka e panjohur. Si i thonë fjalës, “i zoti e di ku i pikon çatia”, por këtë e dinë shumë mirë nxënësit, prindërit dhe tërë opinioni shoqëror. Kjo thuhet në kafe, në familje e kudo që bie fjala për shkollën. Ka pasur edhe ndonjë specialist arsimit apo drejtues që e ka thënë me kurajo nëpër studiot televizive. Është kjo arsyeja që jo në pak raste prindërit i “zë data” kur fëmijët u bien me mësues të rinj dhe, jo rrallë, bëjnë çdo marifet për të ndërruar klasën, shkollën e deri në transferime fëmijësh tek të afërmit në vendbanime të tjera apo rreken t’ua shtyjnë ose t’i regjistrojnë para kohe fëmijët në klasën e parë, që t’ua mësojnë mësuese me përvojë. Konferenca Kombëtare tregoi se këtë problem jetik për shkollën dhe të ardhmen e vendit e njohin qeveria, MASH, Parlamenti, presidenca, partitë politike, por problemi nuk është aq i thjeshtë për t’u zgjidhur në kushtet e sotme. Ai është sa delikat aq edhe i vështirë. Mjaft etiketime të mësuesit në fillimet e proceseve demokratike, vështirësitë e padiskutueshme të profesionit, paga relativisht e ulët, ndonëse gjatë 5 viteve të qeverisë Berisha ka pësuar rritje të ndjeshme, mungesa e statusit të nëpunësit civil, zilia e mësuesve mediokër ndaj mësuesve të aftë për zhvillim kurseesh, hapësira e pakët për karrierë etj, i bëjnë të rinjtë cilësorë t’i largohen këtij profesioni të respektuar e të nderuar në traditën tonë të hershme dhe në botën e qytetëruar. Mirëpo moszgjidhja e një ngërçi të tillë me politika largpamëse, me çdo sakrificë dhe me çdo kosto, sfidon përpjekjet e qeverive për të rritur cilësinë e formimit të brezit të ri dhe komprometon të ardhmen e vendit. Sepse arsimimi i brezit të ri nuk është si puna e shijes së ushqimit që provohet menjëherë. Shija e shkollimit zbulohet shumë vonë, aq vonë sa shpagimi apo kompensimi i ndonjë nxitimi apo eksperimenti të gabuar, s’të hynë më në punë. Për ta joshur rininë drejt profesionit të mësuesit, përgjegjësi të madhe ka vetë shkolla dhe mësuesit, që me jetën e gjallë dhe personalitetin vetjak, ta bëjnë





tërheqës profesionin e tyre. Por kjo mund të realizohet vetëm nga mësues pasionantë e cilësorë, që sapo vete e pakësohen. Sepse vetëm mësuesit me kulturë, personalitet profesional, dinjitet dhe etikë qytetare e bëjnë të pëlqyeshme figurën e mësuesit. Një rol po aq të rëndësishëm ka edhe media, e cila mund të sjellë në ekrane apo në faqet e shtypit të shkruar si modele për rininë lloj-lloj diletantësh mediokër: këngëtarë, aktorë, sportistë, politikanë, gazetarë, drejtues emisionesh, por kurrë nuk gjen dot nëpër shkolla nxënës të shkëlqyer, fitues konkursesh e olimpiadash, arsimtarë të talentuar, nga duart e të cilëve dalin politikanët, deputetët, kryeministrat, presidentët dhe vetë ata që bëjnë programacionet mediatike. Me një gjendje të tillë të mësuesisë as që diskutohet të flasim për të prekur orbitat e vendeve të zhvilluara, kur dihet sa rëndësi e kujdes i kushtojnë vendet e zhvilluara demokratike cilësisë së mësuesve.

Sigurisht pajisja e brezit të ri me kulturën bashkëkohore është obligim i legjislativit dhe ekzekutivit. Dhe është fakt se qeveria vitet e fundit ka bërë një punë të lavdërueshme në drejtim të mbarëvajtjes së shkollës sonë. Përmendim këtu pajisjen e të gjitha shkollave me kabinate informatike, lidhja me Internetin, tekstet alternative etj, por pa u gjetur mekanizmi i përmirësimit cilësor të burimeve njerëzore, avancimet do të jenë shumë të zbehta. Vetëm mësuesit cilësorë e vënë në lëvizje, e gjallërojnë dhe i japin jetë sistemit, sado i përsosur të jetë ai. Pa diskutim që MASH, e cila jo vetëm zbaton, por edhe inspiron e përpunon filozofinë, politikën e strategjinë e arsimit parauniversitar, ka bërë mjaft për të motivuar e mbështetur të rinjtë në zgjedhjen e degës së mësuesisë, mirëpo kjo punë mbetet në kuadrin e propagandës. Duhet të pranojmë pa nervozizëm e qejfmbetje se në arsimin parauniversitar ka ekzistuar dhe ekziston një shpëputje midis sistemit të administrimit-menaxhimit dhe bazës. Këtë e kemi parë përmes prononcimeve në shtypin e shkruar, në mediat elektronike dhe në ballafaqimet direkt, ku specialistët e MASH janë mjaft euforikë, por retorika ndodhet larg realitetit të shkollave. Cilësia e punës nuk arrihet as me fjalë e as me shkresa, por me njohjen e realitetit dhe punën e gjallë dhe krijuese të stafëve mësimore për ta sfiduar realitetin, gjë që kërkon së pari mësues me intelekt, pasion e vullnet. MASH ka shumë mekanizma për nxitjen e zgjedhjes së degës së mësuesisë nga nxënësit cilësorë. Ja disa nga ato siç i mendoj unë:

1. Të rritet disiplina si metodë drejtimi në shkollë dhe të perfeksionohen filtrat e selektimit të nxënësve sipas vlerave reale për në shkollat e larta. Kështu do të rritet angazhimi, përgjegjësia dhe motivimi i nxënësve për procesin mësimor-edukativ.

2. Kategorizimi i diplomave sipas modeleve perëndimore dhe në emërtesat, pagat dhe njohjen e studimeve pasuniversitare të aplikohet hierarkia e diplomave (d.m.th lista e notave). Se na ndodh që mësuesit mediokër sigurojnë edhe mastera, për të konsoliduar vendin e punës dhe për të aspiruar poste drejtuese.

3. T'i pritët rruga korrupsionit nëpër universitetet shtetërore për marrjen e provimeve nga studentët sipas formulës "hesap i qëruar, punë e mbaruar" dhe t'u ndalet hovi universiteteve private në garën e shfrenuar kush e kush ta japë më lehtë diplomën dhe masterin, me sa më pak mundim e angazhim.

4. Përzgjedhja e drejtuesve të shkollave, zyrave arsimore dhe drejtorive arsimore të bëhet mbi kritere të rrepta profesionale dhe integriteti moral.

5. Emërimet e mësuesve të rinj të bëhen me anë të konkurseve serioze dhe jo mbi bazën e njohjes, nepotizmit apo aferave korruptive, që tashmë janë evidentuar.

6. Të rritet numri i pikëve për pranimet në degët e mësuesisë. Sepse është skandal që në të gjitha universitetet numri më i lartë i pikëve të kërkuara për degën matematikë-fizikë sivjet ishte 2750, gjë të cilën e arrin çdo maturant, i cili mesataren, provimet e detyruara dhe ato me zgjedhje i merr. Që me prezantimin e listës së pikëve perceptimi i kandidatëve për shkollat e larta është se mësuesia mbetet degë e dorës së fundit nga vetë shteti demokratik.

Të gjithë studiuesit për konceptin e mësuesit sot bashkohen në një pikë:

Përvoja e punës të ndihmon e korrigjon vazhdimisht, por tharmi i personalitetit shkencor dhe autoritetit të mësuesit është përgatitja në shkollën e lartë. Që do të thotë se mësuesi duhet të jetë një shfaqje harmonish të rastit dhe të kultivuara.

Dhe këtu s'është fjala për ca parime konvencionale... Me të drejtë para disa kohësh një prind nga Durrësi shkruante në shtypin e ditës se mësuesit e vjetër do t'i kërkojmë si mjaltin e gështenjës. Në qoftë se nuk do të ndryshohet gjendja aktuale e përgatitjes së mësuesve, kur të fillojnë të dalin në masë mësuesit e vjetër në pension, që i bie të fillojë nga 2015, arsimit parauniversitar do t'i ngjajë një ngrehinë të re me themele prej rëre. Në këto kushte është anormale që në disa zyra e drejtorit arsimore t'u bëhet presion mësuesve të ciklit të ulët me arsim të mesëm dhe me stazh 25-35 vjeçar, duke u tundur listat e gjata të pretendentëve të rinj me "arsim të lartë". Preteksti gjendet tek një vendim i MASH para disa vjetësh dhe që sot tingëllon absurd, të cilit iu kundërvu me forcë opinioni i mësuesve dhe ai shoqëror sapo u shpall dhe vetë MASH pranoi në televizion se vendimi nuk prekte mësuesit me mbi 20-25 vjet punë.

Lexuesi, që mund të më paragjykojë si mosbesues ndaj brezit të ri dhe nostalgjik ndaj së vjetrës, do të jetë i nxituar dhe i pasinqertë me veten. Një gjë është e qartë se në kohën tonë fjalën e ka rinia dhe ambicia.

Sfida e vërtetë e gjimnazit

Mendime rreth kurrikulës së re të gjimnazit

Nikolin GËRMENJI

Gjimnazi "Themistokli Gërmenji" - Korçë

Pas një periudhe të gjatë dhe të vështirë tranzicioni, në të cilën u duk se arsimit ende nuk e kishte krijuar profilin e vet; pas shumë provash dhe eksperimentimesh që herë-herë ndikuan dhe lanë gjurmë në sistemin arsimor, duket se më në fund reformat rrënjësore të nisura me Maturën Shtetërore, Altertekstin, sistemin 9-vjeçar të detyrueshëm, etj. po kulmojnë me kurrikulën e re të gjimnazit.

Kjo kurrikulë përbën një sfidë dhe si e tillë ajo kërkon vëmendjen dhe përkushtimin e duhur, për të bërë të mundur që në edukimin e brezave të ndikojnë të gjithë faktorët e shoqërisë. Ndonëse mund të duket se i përket vetëm shkollës, ajo në të vërtetë është një sfidë që i bëhet shoqërisë. Perceptimi dhe filozofia që e përshkon këtë kurrikulë janë parimet mbi të cilat duhet të ndërtohet shoqëria e së nesërme evropiane.

Misioni i kësaj kurrikule është të përgatitë brezin e së nesërme evropiane për t'u përballur me dinjitet me bashkëmoshatarët e vet kudo nëpër Evropë. Për të realizuar këtë mision, një rol të rëndësishëm, madje të pazëvendësueshëm duhet të luajë mësuesi.

Mësuesi, në radhë të parë, duhet të njohë dhe të kuptojë filozofinë mbi të cilën ngrihet kjo kurrikulë, çfarë ofron ajo dhe më pas këtë t'ua përcjellë edhe nxënësve.

Në kohërat që po jetojmë, nxënësi ka ndryshuar shumë dhe po ndryshon gjithmonë e më shpejt. Mësuesit i takon të ndjekë ritmin e këtij ndryshimi. Sfida që paraqet ky ndryshim nuk ka të bëjë me ndryshueshmërinë dhe rritjen e informacionit as me nivelin e njohurive shkencore, por me detyrën e vështirë të formimit të karakterit dhe rritjes personale të nxënësve, me krijimin e individit, qytetarit të ardhshëm evropian.

Për të kuptuar këtë mision, mësuesit duhet të njohin thelbin e këtij ndryshimi kurrikular.

Kurrikula e re e gjimnazit nuk është thjesht një pamje e re, një fasadë brenda së cilës gjallojnë idetë e vjetra apo të sistemit të mëparshëm arsimor. Ajo është një konceptim krejtësisht i ri dhe i ndryshëm nga ai me të cilin shumë prej mësuesve, për të mos thënë të gjithë, janë mësuar apo kanë njohur.

Në radhë të parë, është e rëndësishme që mësuesi të ketë të qartë se koncepti kurrikular nuk mund dhe nuk ka si të identifikohet vetëm me përmbajtjen apo metodikën.

Kurrikula përfshin shumë faktorë dhe shumë elementë, por faktorët më të rëndësishëm që përbëjnë një kurrikulë janë: PËRMBAJTJA - OBJEKTIVAT - METODOLOGJIA - VLERËSIMI.

Nëse në kurrikulën e vjetër, gjithçka buronte dhe e kishte pikënisjen nga PËRMBAJTJA, prej së cilës dilnin OBJEKTIVAT për realizimin e të cilave kishte një vlerësim unik dhe të ngurtësuar; në kurrikulën e re boshti orientues bëhen OBJEKTIVAT.

Për realizimin e këtyre objektivave hartohen programe të përcaktuara që materializojnë përmbajtjen; rekomandohen met-

odologji që lehtësojnë të nxënësit e kësaj përmbajtjeje, hartohen tekste alternative që ndihmojnë në tejçimin e kësaj përmbajtjeje dhe përpunohen sisteme vlerësimi që matin këto arritje.

Ky konceptim i kurrikulës do të thotë në thelb të tij që mësuesi të ndihet i lirë. Por duket se liria aq shumë e dëshiruar e ka trembur mësuesin ose më mirë të them e ka hutuar.

Të gjendur para sfidës së lirisë profesionale, shumë mësues ende e shohin, e gjykojnë dhe mbi të gjitha e vënë në zbatim këtë kurrikulë nisur nga konceptimi i mëparshëm duke mbetur rob i skemave të vjetra të mësimdhënies.

Vështirësia e parë dhe më e prekshme shfaqet në hartimin e planeve mësimore. Ndonëse paraprakisht në vitet e mëparshme është eksperimentuar në planet mësimore me orët e lira, shumë mësues e kanë të vështirë zberthimin e programit dhe konceptimin e tij, sepse tek ta është rrënjësuar mendimi se teksti është program dhe anasjelltas. Ende ka mësues që mësimdhënien e shohin me në qendër tekstin dhe jo nxënësin. Teksti, ashtu si edhe shkumësi apo tabela e bardhë apo e zezë qoftë ajo, është një mjet me të cilin do të realizohet programi, rrjedhimisht objektivat. Por duke qenë se teksti, apo libri është një mjet që e përdor nxënësi, detyra e mësuesit është, që për të lehtësuar procesin e nxënies dhe në përputhje me

veçoritë e nxënësve, të përzgjedhë atë tekst që u përgjigjet këtyre nevojave dhe sigurisht që plotëson kërkesat e programit. Kështu kjo kurrikulë ndërthur reformën e altertekstit me reformën e re të gjimnazit. Mësuesit tashmë i del detyra që të jetë i përgjegjshëm dhe aktiv në procesin e përzgjedhjes së teksteve duke mos u ndikuar nga faktorë jo profesionalë apo edhe nga ata mediatikë. Një tekst i përzgjedhur mirë i lehtëson punën mësuesit dhe ndihmon të nxënësit e

nxënësve. Tradita e vjetër e cila e detyroi mësuesin të kthehet në një riprodhues të tekstit apo rob të tij, merr fund. Mësuesi është i lirë, por jo i papërgjegjshëm. Ai tani merr mbi supë përgjegjësinë për zgjedhjet e tij.

Parimi i zgjedhjes, gjithëpërfshirjes, fleksibilitetit në hapësirë dhe kohë, koherenca dhe integrimi si dhe të nxënësit gjatë gjithë jetës, janë parimet bazë mbi të cilat ndërtohet kjo kurrikulë.

Si çdo kurrikulë ajo është hartuar për t'u shërbyer nxënësve, për këtë është shumë e rëndësishme të kuptohet dhe të vihen në zbatim këto parime sidomos nga shkollat dhe drejtoritë e tyre. Kurrikula e re e gjimnazit bazohet dhe synon të realizojë njëherësh dy të drejta themelore të nxënësve: të drejtën e shanseve të barabarta dhe të drejtën për të qenë i ndryshëm.

Këto dy të drejta duhen kuptuar siç duhen dhe duhet bërë çmos të realizohen. Në këtë kuadër një rol të rëndësishëm merr vendimmarrja në shkollë. Kurrikula mbështetet në orientimet e dhëna vitet e kaluara si dhe në vendimin për ngritjen e ekipit kurrikular të shkollës. Nëse kjo strukturë deri vitin e kaluar ka

Sfida e vërtetë e gjimnazit është pranimi i ndryshimit dhe profesionalizmi. Koha sot kërkon jo thjesht mësimdhënës, aq më pak riprodhues tekstesh, por udhërrëfyes dhe profesionistë të aftë për të marrë përgjegjësi dhe për të dhënë zgjidhje. Kjo është fryma që kurrikula e re kërkon të edukojë tek brezi i ri. Kjo është sfida e shoqërisë sonë drejt integritit evropian.

funksionuar pak ose aspak, me kurrikulën e re bëhet i domosdoshëm funksionimi i saj dhe madje shumë rregullt. Vërtet drejtorja e shkollës dhe vetë drejtori i një gjimnazi duhet të luajë rolin e një menaxheri, por pa mbështetjen, mendimet dhe përgjegjësitë që duhet të marrë ky ekip realizimi i plotë dhe i suksesshëm i kësaj kurrikule vihet në pikëpyetje. Në këtë drejtim, mendoj se edhe ligjërishi, këtij ekipi i duhet kushtuar më shumë rëndësi dhe vlerësim. Në ato shkolla ku kjo vendimmarrje bëhet vetëm me urdhrin e drejtorit apo vendimet e tij, shpesh janë bërë edhe gabime ose shkelje të cilat në rastin më të mirë mund të shkaktojnë keqkuptim për kurrikulën e re, kurse në rastin më të keq mund të kenë pasoja edhe në diplomimin e nxënësve ose në penalizimin e tyre për të mos realizuar ato objektiva që synon shkollimi në gjimnaz. Vështirësi në këtë drejtim duket se ka planifikimi nga shkolla i lëndëve me zgjedhje të lirë, por sidomos të lëndëve apo moduleve me zgjedhje të lirë.

Përsa u përket zgjedhjeve të lëndëve të detyruara, vështirësia më e madhe shfaqet në njohjen dhe rëndësinë e këtyre zgjedhjeve dhe në faktin që secila zgjedhje përjashton automatikisht tjetrën, d.m.th., nëse një nxënës zgjedh lëndën e matematikës, apo letërsisë së avancuar ai nuk mund të zgjedhë gjuhët e huaja apo TIK ose trashëgimi. Kështu që ndarja nëpër klasa natyrshëm bëhet sipas këtyre zgjedhjeve.

Problem tjetër që duket se shfaqet në zgjedhjet me detyrim, janë gjuhët e huaja. Sipas qarkores për zhvillimin e gjuhëve të huaja në arsimin parauniversitar, nr. 4136, datë 15.07.2009, thuhet se gjuhët e huaja në shkollën e mesme duhet të mësohen në vijimësi të gjuhës së nisur në arsimin bazë. Kjo do të thotë që gjuhë e huaj e parë detyrimisht duhet të jetë gjuha e huaj me të cilën vjen nga shkolla 9-vjeçare nxënësi. Por në disa shkolla, në vijimësi të "Programit Iliria", gjuha e parë e huaj e detyruar bëhet italishtja, kështu që nxënësve që vijnë nga shkollat 9-vjeçare ku zhvillohen gjuhë të tjera të huaja si anglishtja, apo frëngjishtja shkelet urdhri i mësipërm, pra u privohet e drejta për të ndjekur në vazhdimësi gjuhën e huaj. Këto përplasje duhet të rishqyrtohen nga drejtuesit e shkollave, por njëkohësisht edhe ata vetë të tregohen me fleksibël në planifikimin e kurrikulës me zgjedhje. Sigurisht, këtu ndihet e nevojshme edhe një ndërhyrje apo sqarim nga DAR për të orientuar kontingjentet e nxënësve në shkollat e mesme sipas specifikave gjuhësore që ato kanë.

Por profilin dhe fizionominë e vërtetë gjimnazeve do t'ua japin lëndët dhe modulet me zgjedhje të lirë. Është kjo liri kurrikulare që duhet të vërë drejtuesit dhe stafet mësimore në punë për të krijuar dhe nxitur çdo mësues që e ndjen veten të aftë të shprehë mundësitë dhe dijet e veta në shërbim të shkollës dhe sigurisht edhe të vetvetes. Drejtuesit e gjimnazeve kanë një rast për ta bërë shkollën e tyre tërheqëse dhe të kërkuar nga nxënësit duke ofruar një "meny" të pasur me projekte kurrikulare, module apo lëndë të hartuara dhe planifikuara nga vetë mësuesit e shkollës. Sigurisht që modulet apo lëndët e rekomanduara nga IKT janë një shtysë e mirë, por kjo nuk do të thotë që për hir të qetësisë dhe rehatllëkut të katandisen shkollat që të zhvillojnë vetëm lojëra sportive dhe guidë turistike apo kërcim. Këtu kam parasysh faktin që mundësitë që krijon kurrikula janë të mëdha, por për të duhet menduar me përgjegjësi dhe seriozitet.

Një tjetër shqetësim që duket se kjo kurrikulë u hap drejtuesve të gjimnazeve është edhe fakti që nxënësi duhet të ketë minimalisht 18 orë shërbim komunitar. Ndonëse një term i ri dhe shumë bashkëkohor, në thelb ky detyrim nuk është gjë tjetër veçse puna vullnetare, që brezat e mëparshëm e njohin dhe e dinë se çfarë është. Por tani i konceptuar në një formë shumë



bashkëkohore ai merr një rëndësi shumë të madhe në edukimin qytetar të nxënësve.

Të mësuar me konceptin e vjetër se procesi mësimor kryhet vetëm brenda shkollës a thua se shkolla nuk lidhet me jetën dhe komunitetin, drejtuesit e gjimnazeve e shohin si sfida më vetë këtë detyrim. Edhe pse në të vërtetë ai është një sfida, kjo ka të bëjë më thyerjen e mendësisë dhe konceptimit që kanë për jetën të rinjtë e sotëm që e bazojnë çdo gjë vetëm mbi fitimin. Ky shërbim nëse nuk është i mundur të kryhet gjithmonë në institucionet e tjera, apo shoqatat e ndryshme, shumë mirë mund të kryhet brenda shkollës. Nxënësit mund të mirëmbajnë, lyejnë, pastrojnë, gjelbërojnë apo sistemojnë mjediset e shkollës dhe aty të vlerësohen për shërbimin që kryejnë. Por shumë mirë ky shërbim mund të bëhet në muajin e pyllëzimit, në të cilin nxënësit mund të japin ndihmesën e tyre për gjelbërimin dhe mbrojtjen e mjedisit qoftë në shkollë, rreth saj apo edhe në komunitet. Ky shërbim sigurisht që nuk mund të kryhet vetëm gjatë kohës së mësimit, por edhe jashtë saj, madje edhe gjatë pushimeve verore. Një rol shumë të rëndësishëm në këtë drejtim mendoj se duhet të luajnë edhe institucionet e pushtetit vendor dhe bordet e shkollave për të ndihmuar në realizimin e këtyre detyrimeve.

Në gjithë këtë proces dhe zhvillim të kurrikulës një rol shumë të rëndësishëm luan vlerësimi. I parë shumë herë si një mjet me të cilin mësuesit vendosnin autoritetin e tyre dhe në disa raste i kthyer edhe në mjet presioni, konceptimi i ri i vlerësimit kërkon që ai të kryhet jo për të frenuar nxënësin, as për ta trembur, por për ta nxitur. Klasifikimi i vlerësimeve sipas një përqindjeje të caktuar shërben që ora e mësimit të jetë sa më pak e ndikuar nga frika e notës dhe nxënësi të ndihet sa më i çlirët. Ky lloj vlerësimi i krijon mësuesit mundësinë të jetë më i qetë për vlerësimin gojor dhe për punët individuale duke i dhënë rëndësinë dhe vlerën e duhur testimeve dhe provimeve përfundimtare. Tashmë sfida e vërtetë para mësuesve nuk është thjesht objektiviteti, por profesionalizmi. Të gjendur përballë kësaj mënyre vlerësimi mësuesit duhet të ndërëgjegjësohen se vlera e notës së një testimi vërtet është më e madhe, por me po të njëjtën madhësi rritet edhe përgjegjësia profesionale për të hartuar teste standarde dhe të mbështetura në objektivat e vëna që në fillim të vitit dhe çdo orë mësimore. Në këtë drejtim mendoj se ka nevojë për ndihmë dhe orientim si nga stafet drejtuese të shkollave, ashtu edhe nga specialistët e kualifikimit të DAR/ZA-ve.

Duke përfunduar, mendoj se sfida e vërtetë e gjimnazit është pranimiti i ndryshimit dhe profesionalizmit. Koha sot kërkon jo thjesht mësimdhënës, aq më pak riprodhues tekstesh, por udhërrëfyes dhe profesionistë të aftë për të marrë përgjegjësi dhe për të dhënë zgjidhje. Kjo është fryma që kurrikula e re kërkon të edukojë tek brezi i ri. Kjo është sfida e shoqërisë sonë drejt integritit evropian.

Hartimi i planit mësimor

Nazmi XHOMARA - IZHA

Strukturat e formatit të planifikimit mësimor janë të ndryshme për shkak të ndikimit të një morie faktorësh dhe përbëjnë atë që quhet “liria akademike e mësuesit”. Por cilido qoftë formati i zgjedhur, struktura e tij ka një vijë logjike.

I - Struktura e planit mësimor

Hartimi i një plani mësimor adekuat bazuar në programin mësimor përkatës si edhe në burimet e mundshme, do të përbënte një bazament të fortë për të parashikuar suksesin në mësimdhënie. Por, si mund të hartohet një plan i mirë mësimor ?

Nëse do të përdornim një stuhi mendimi në një auditor çfarëdo mësimdhënësish, me siguri do të merrnim një shumëllojshmëri përgjigjesh. Përgjigjet e larmishme kanë të bëjnë me ndikimin e një sërë faktorësh mbi mësuesin si : formimi i tij pedagogjik, eksperiencia në punë, rezultatet e arritura, cikli ku jep mësim, lënda, etj, etj.

Nisur nga konsiderata e mësipërme gjithçka që do të ofrohet në këtë material si: metodika e hartimit të planit mësimor, formati i një plani mësimor, po ashtu edhe një model konkret i zbatuar, përbëjnë vetëm një alternativë, krahas shumë të tjerave që qarkullojnë aktualisht në mjedisin pedagogjik të shkollës.

II - Metodika e hartimit të planit mësimor

Sikurse shumë “operacione” të tjera pedagogjike dhe didaktike edhe hartimi i një plani mësimor i quajtur ndryshe edhe përgatitje ditore e mësuesit, kryhet duke aplikuar një metodikë të caktuar.

Përpara se mësuesi të nisë hartimin e planit mësimor, duhet t’i drejtojë vetes tri pyetje bazike :

- I. Ku do të arrijnë nxënësit e mi ?
- II. Si do të arrijnë atje ?
- III. Si do ta mësoj nëse kanë mbërritur atje ku duhet ?

Siç dihet, ekzistojnë formate të ndryshme të planifikimit të mësimit. Secili format është i ndërtuar nga një strukturë e caktuar elementesh përbërës. Strukturat e formatit të planifikimit mësimor janë të ndryshme për shkak të ndikimit të një morie faktorësh dhe përbëjnë atë që quhet “liria akademike e mësuesit”. Por cilido qoftë formati i zgjedhur, struktura e tij ka një vijë logjike, të cilën nisur edhe nga tri pyetjet bazike të dhëna më sipër, po e përmbledhim me tre terma :

- I. Objektivat
- II. Strategjia e mësimdhënies
- III. Vlerësimi i performancës

III - Formatit i një plani mësimor

1 - Synimi/synimet

Synimi përcakton qëllimin, aspiratën dhe

shkakun themelor, për të cilin mësuesi dhe nxënësit e tij do të angazhohen gjatë orës mësimore. Mësuesi duhet ta përdorë këtë seksion për të shprehur objektiva mësimore afatmesme që nxirren nga planifikimet lëndore dhe që vendosen në këtë stad/fazë duke i përgatitur nxënësit për përvetësimin e njohurive dhe zhvillimin e veprimtarive të ardhshme. Synimi formulohet si një objektivi i gjerë edukimi, apo si një objektivi kapitulli, duke e parë si pjesë të standardeve të kurrikulës kombëtare. Për të formuluar saktë synimin, mësuesi duhet t’ju japë përgjigje këtyre pyetjeve :

Cilat janë objektivat e gjerë, aspiratat apo qëllimet e kapitullit dhe të kurrikulës ?

Cilat janë qëllimet tuaja për këtë kapitull ?

Çfarë prisni nga nxënësit që të jenë në gjendje të bëjnë në fund të kapitullit ?

2 - Objektivat

Ky seksion fokusohet në atë se çfarë do të bëjnë nxënësit për të përfutur njohuri dhe shprehje të reja. Objektivat për planin mësimor ditor nxirren nga objektivat e kapitullit, por që duhet të arrihen brenda një periudhe kohore plotësisht të përcaktuar - brenda orës së mësimit. Pyetjet që do t’ju vinin në ndihmë janë :

Çfarë do të jenë në gjendje të bëjnë nxënësit gjatë orës së mësimit ?

Në cilat kushte do të realizohet performanca e nxënësve ?

Cila është shkalla apo kriteri mbi bazën e të cilit do të gjykohet arritja e objektiveve ?

Si do ta demonstrojnë nxënësit se ata i kanë kuptuar dhe përvetësuar objektivat e mësimit ?

3 - Kushtet paraprake

Kushtet paraprake ose kushtet e domosdoshme mund të jenë të dobishme kur mësuesi merr në konsideratë gjendjen e gatishmërisë së nxënësve të tij. Kushtet paraprake e lejojnë mësuesin apo edhe mësues të tjerë të përsërisin planin mësimor për ta faktorizuar në veprimtari paraprake të nevojshme për t’u siguruar që nxënësit mund t’i arrijnë objektivat mësimorë. Pyetjet që do t’ju vinin në ndihmë në këtë rast do të ishin :



Çfarë duhet të jenë në gjendje të bëjnë nxënësit përpara këtij mësimi ?

Cilat koncepte duhen përforcuar për të arritur objektivat e mësimit ?

4 - Mjetet

Ky seksion ka dy funksione: ai ndihmon mësuesit të përcaktojnë me shpejtësi :

a - Sa kohë parapërgatitore, burime dhe menaxhim duhet në realizimin e këtij plani mësuesor.

b - Çfarë materialesh, librash, pajisjesh dhe burimesh duhet të parapërgatiten.

Është shumë e dobishme hartimi i një liste të plotë të mjeteve mësuesore, duke përfshirë citimet e plota të tekstit, apo të çdo burimi tjetër të shkruar. Pyetjet ndihmëse për këtë seksion do të ishin:

Cilat materiale do të jenë të nevojshme ?

Cilat tekste bazë apo literature janë të nevojshme?

Çfarë nevojitet të përgatitet në avancë ?

5 - Përshkrimi i mësimit

Ky seksion ofron një mundësi për autorin e mësimit për të ndarë mendime, eksperiencën dhe këshilla me mësuesit e tjerë. Ai gjithashtu siguron një përmbledhje të mësimit në termat e fokusimit të temës, të veprimtarive dhe të synimit. Pyetjet ndihmëse në këtë seksion do të ishin:

Çfarë është e veçantë për këtë mësime ?

Si do ta pëlqenin nxënësit e tu ?

Cili nivel i taksonomisë Bloom mbulohet nga ky plan mësuesor ?

6 - Ecuria e mësimit

Ky seksion ofron një përshkrim të detajuar hap pas hapi të realizimit të objektivave të planit mësuesor. Ky seksion është i nënkuptuar për mësuesin dhe ofron sugjerime se si të procedojë me zbatimin e planit mësuesor. Ai gjithashtu përfshin të gjitha veprimtaritë që do të bëjnë nxënësit gjatë mësimit. Ky seksion ndahet në disa komponentë bazë :

a - Hyrja

Si do t'i prezantoni idetë dhe objektivat e këtij mësimi ?

Si do të tërhiqni vëmendjen e nxënësve dhe t'i motivoni ato në ruajtjen e interesit për mësime ?

Si mund të lidhni objektivat mësuesore me interesat e nxënësve dhe veprimtaritë e zhvilluara në orët e kaluara ?

Çfarë do të prisni nga nxënësit?

b - Veprimtaria kryesore

Cili është fokusi i mësimit?

Si do ta përshkruani vijimësinë e mësimit tek një mësues tjetër, i cili do ta përsëriste atë?

Çfarë do të bënte mësuesi për të lehtësuar të nxënësit dhe për të menaxhuar veprimtaritë e ndryshme?

Cilat janë disa shembuj pozitiv dhe negativ për të ilustruar atë që po u prezantoni nxënësve?

Si mund të prezantohet materiali për të siguruar që çdo nxënësi do të përfitonte nga eksperiencën e të nxënësit ?

Rregulli 1 :

Merr në konsideratë atë çfarë nxënësit po nxënë : - një shprehje të re, një rregull apo një formulë, një koncept, një fakt, një ide, një mënyrë të vepruarit apo një vlerë.

Zgjidh një nga teknikat e mëposhtme për të planifikuar

përmbajtjen e mësimit, bazuar mbi objektivat tuaja:

Demonstrim - listo detajet dhe sekuencat e hapave që do të kryhen.

Shpjegim - nënvizo informacion që do të interpretohet.

Diskutim - listo pyetjet kyçe që do të udhëheqin diskutimin.

C - Përmbyllja/konkluzionet

Çfarë do të përdorni për të nxjerrë në fund idetë së bashku për nxënësit ?

Si do të siguroni feedback nga nxënësit për të korrigjuar keqkuptimet dhe për të përforcuar të nxënësit e tyre?

D - Veprimtari pasuese

Çfarë aktivitete mund të sugjeroni për pasurimin apo plotësimin e mësimit?

Cilat mësime të ardhshme mund të ndiqni ,të cilat janë të lidhur drejtpërdrejt me këtë mësime?



7 - Vlerësimi

Ky seksion fokusohet në garantimin që nxënësit tuaj kanë arritur në destinacionin e parashikuar. Ju duhet të grumbulloni të dhëna që e vërtetojnë këtë. Zakonisht kjo realizohet duke grumbulluar punët e nxënësve dhe duke i vlerësuar ato, duke përdorur disa rubrika të përshkallëzuar bazuar në objektivat mësuesore. Ju gjithashtu mund të përdorni disa veprimtari që keni praktikuar gjatë mësimit, por duke përdorur një nivel më të ulët drejtimi nga ana e mësuesit. Gjithashtu mësuesi mund të ndërtojë pyetje mbi koncepte apo probleme të ndryshme. Pyetjet, të cilat mësuesi mund t'ju jepte përgjigje në këtë rast :

Si do t'i vlerësoni objektivat që ishin identifikuar?

A e kanë praktikuar nxënësit materialin që ju keni dhënë për vlerësim?

Rregulli 2

Sigurohu që nxënësit kanë praktikuar materialin që ju po përdorni për vlerësim. Asnjëherë nuk duhet përdorur materialin e ri gjatë kësaj faze. Gjithashtu shmang pyetjet me nivel të lartë, nëse nxënësit nuk kanë arritur t'i bëjnë këto gjatë mësimit. P.sh. nëse ju kërkoni nxënësve të zbatojnë njohuri apo shprehje, ata duhet së pari t'ju krijohet mundësia t'i kenë aplikuar gjatë mësimit.

Rregulli i përgjithshëm:

Plani juaj mësuesor duhet të jetë i detajuar dhe i plotë në mënyrë që një mësues tjetër i kësaj lënde të mund ta zhvillojë mësimin pa kontaktuar me ju dhe pa patur nevojë për sqarime të tjera.

Organizimi i mësimit me grupe nxënësish

Në arsim përdoren një sërë metodash mësimore për organizimin e mësimit.

Përvojat pozitive kanë treguar që organizimi i mësimit me metoda të reja bashkëkohore ka ngjallur interes më të madh te nxënësit për të nxënë të tyre. Një nga metodat frytdhënëse është edhe "Puna me grupe". Zbatimi i kësaj metodë u mundëson nxënësve familiaritet më të madh midis tyre, rrit frymën e bashkëpunimit dhe të ndihmës ndaj njëri-tjetrit dhe nxit konkurrencën midis grupeve të tyre.

Puna me grupe - Nuk gjendet një limit i caktuar në të cilin mësuesit mund të grupojnë nxënësit në një klasë. Megjithatë, mësimdhënia në një klasë si një grup i tërë, mësimi individual ose paraqitja e punës në grupe, kanë epërsitë dhe mangësitë e tyre. Secila është më shumë ose më pak e përshtatshme për aktivitete të ndryshme.

Mësimi me tërë klasën - Kur njerëzit mendojnë për mësimdhënien, ata krijojnë një figure të nxënësve në rradhë duke dëgjuar mësuesin i cili është përpara tyre. Për shumicën prej tyre, ky është kuptimi i një ore mësimore dhe kjo është akoma lidhja nxënës-mësues më e përgjithshme për shumë kultura. Megjithatë puna me të tërë klasën, si një grup i vetëm i ka epërsitë dhe mangësitë e veta.

Epërsitë e punës në klasë si një grup i vetëm:

Disa nga epërsitë kryesore të mësimit në klasë si një grup i vetëm janë renditur më poshtë:

Forcon ndjenjën që i përket një grupi dhe je një anëtar i tij - diçka që si mësues duhet ta konsolidojmë. Në qoftë se secili nxënës është i përfshirë në të njëjtën veprimtari, atëherë ne jemi të gjithë të përfshirë në të njëjtën veprimtari së bashku. Të tilla përvoja na japin ne, pika referimi të përbashkëta për të biseduar dhe konsiderohen si mundësi për tu afruar me njëri-tjetrin. Është më e lehtë për nxënësit të ndajnë emocionet në një veprimtari mësimore të përbashkët. 20 nxënës duke qeshur është shpesh më e kënaqshme se dy nxënës.

Është e përshtatshme në veprimtaritë ku mësuesi luan rolin e kontrolluesit - veçanërisht e mirë për dhënien e shpjegimeve dhe udhëzimeve, ku për grupe më të vogla, duhet t'i theksojë ato për disa herë. Është një mënyrë ideale e paraqitjes së materialeve në piktura, postera, tekste, audio ose video.

Është një mënyrë e mirë për mësuesit të kenë një kuptim të përgjithshëm të progresit të nxënësve - mënyra e preferuar ku nxënësit dhe mësuesit

Elisabeta Prifti - Mësuese e gjeografisë
Majlinda Pacani - Mësuese e anglishtes

ndjehen më të sigurt kur e gjithë klasa punon me të njëjtin hap, dhe nën drejtimin direkt të mësuesit.

Mangësitë e punës në klasë si një grup i vetëm

Si mangësi apo vështirësi mund të përmenden:

Favorizimi i grupit më tepër se individit - secili është i detyruar të bëjë të njëjtën gjë dhe në të njëjtën kohë.

Pakësimi i shanseve që nxënësit të bëjnë diçka vetë në mënyrë individuale.

Shton rrezikun e dështimit si grup - disa nxënës nuk kanë aftësi të paraqesin punët përpara të tjerëve kështu që ritet shansi për të dështuar si grup.

Mungesa e inkurajimit të nxënësve për të marrë përgjegjësi individuale - mësimi me tërë klasën favorizon transmetimin e njohurive nga mësuesi te nxënësi më tepër se zbulimi i dukurive apo informacionit nga vetë nxënësi.

Mënyrë jo e mirë e organizimit të mësimdhënies komunikuese - komunikimi ndërmjet individëve është më i vështirë në një grup prej 20 ose 30 nxënës, se në një grup me 5 ose 4 nxënës. Në grupe më të vogla është më e lehtë të ndash materialin, të flasësh qetë, më pak formalisht dhe të mbash kontakt mjaft të mirë me sy me të gjithë nxënësit. Të gjitha këto kontribuojnë në zgjidhjen e detyrave me sukses.

Puna individuale e nxënësve - E kundërta e punës me tërë klasën është puna individuale. Në të përfshihen, të gjitha veprimtaritë që nga kryerja e ushtrimeve të nxënësve, deri te situatat në të cilat mësuesit punojnë në mënyrë individuale me nxënësit, ose kur nxënësit punojnë jashtë mjediseve shkollore. I tillë mësim individual është themelor në autonominë e të nxënësit. Në qoftë se mësuesit duam që nxënësit të punojnë në mënyrë individuale në klasë, atëherë ata mund të lejojmë nxënësit të lexojnë privatisht dhe pastaj t'i përgjigjen pyetjeve individualisht; të kërkojnë që nxënësit të plotësojnë fletë pune



ose detyra me shkrim.; t'u japin fletë pune me detyra të ndryshme dhe t'i lejojmë ata të vendosin për detyrën që duan të bëjnë, bazuar në aftësitë e tyre.

Epërsitë e mësimit individual

I lejon mësuesit t'i përgjigjen ndryshimeve individuale të nxënësve.

Është më pak stresuese për nxënësit se sa puna në grupe ose me tërë klasën.

Zhvillon autonominë e të nxënësve, aftësinë e vetëbesimit dhe të kërkimit jashtë varësisë së mësuesit.

Është mënyrë e rivendosjes së paqes kundrejt një situatë kaotike dhe më të zhurshme.

Mangësitë e mësimit individual

Nuk inkurajon bashkëpunimin në të cilin nxënësit mund të ndihmojnë dhe motivojnë njëri-tjetrin.

Kur kombinohet me dhënien e detyrave të ndryshme individuale, nxënësve, u kërkohet më tepër përgatitje dhe material, se sa në punën me tërë klasën.

Nxënësve, realizimi i detyrave apo veprimtarive të caktuara u merr më tepër kohë se bashkëpunimi me tërë klasën.

Puna në grupe me dy nxënës ose në çifte - Në këtë lloj aktiviteti nxënësit mund të praktikojnë aftësitë gjuhësore së bashku, studiojnë një tekst, kryejnë kërkime dhe vëzhgime. Ato mund të shkruajnë dialogje, përmbajtjen e një teksti të lexuar ose të krahasojnë shënime me çfarë ata kanë lexuar më parë.

Epërsitë e punës në grupe me dy nxënës ose në çifte:

Rrit pjesën e kohës që një nxënës flet në klasë.

I lejon mësuesit të punojë dhe të bashkëveprojë me një ose dy çifte ndërsa të tjerët vazhdojnë punën.

I lejon nxënësit të punojë dhe të bashkëveprojë pa qenë e nevojshme drejtimi i mësuesit.

Është relativisht i shpejtë dhe i lehtë për t'u organizuar.

Vërteton thënien që dy mendje janë më mirë se një.

Nxit bashkëpunimin dhe ndihmën për të pasur një ambient çlodhës dhe miqësor në klasë.

Duke punuar në çift mësuesi i jep nxënësve mundësi të ndajnë përgjegjësitë dhe jo të mbajnë peshën e rëndimit mbi vete.

Mangësitë e punës në çift:

Puna në grupe me dy nxënës është shpesh e zhurmshme dhe mësuesit përqëndrohen në mbajtjen e klasës nën kontroll.

Ekziston mundësia që nxënësit të flasin për një temë krejtësisht të ndryshme nga detyra e caktuar

Zgjedhja e nxënësve që do të punojnë bashkë, mund të jetë problematike, sidomos për ata të cilët duan të punojnë me nxënës jo të preferuar për ta.

Puna në grup - Nxënësit punojnë në grupe, pasi u mundëson të përmbushin një sërë detyrash për të cilat puna në çift është e pamjaftueshme dhe jo e duhur. Grupet duhet të përfshijnë të



paktën 5 nxënës të cilët mund të përgatisin një prezantim ose të diskutojnë rreth një temetë caktuar, duke marrë vendimin në grup. Grupe të vogla mundësojnë përfshirje dhe pjesëmarrje më të madhe. Numri 5 është numër tek që do të thotë që mendimi i shumicës mbizotëron.

Përparësitë e punës në grup:

Rrit sasinë e kohës që secili nxënës ka për të folur.

Marëdhëniet personale janë më pak problematike, ndryshe nga puna në çift.

Krijohet mundësi më e madhe për larmi opinionesh dhe kontribut të frytshëm.

Nxit autonominë e nxënësve duke i lejuar ata të marrin vendimet e tyre në grup pa u vëzhguar në çdo hap nga mësuesi përkatës.

Gatishmëri për të marrë pjesë aktive në diskutime në krahasim kur punohet me të gjithë klasën.

Mangësitë e punës në grup:

Mundësi më e madhe që mësimi të jetë i zhurmshëm. Disa mësues mund të humbin kontrollin e klasës, kur ajo është ndarë në grupe, duke 'minuar' disi rregullin e vendosur në fillim të orës së mësimit.

Jo të gjithë nxënësit e pëlqejnë këtë mënyrë organizimi, pasi ata preferojnë më mirë të jenë në qendër të vëmendjes së mësuesit, sesa të punojnë me shokët dhe shoqet e tyre.

Disa prej nxënësve ankohen për përbërjen e grupeve duke shprehur dëshirën për të qenë pjesëtar i një grupi tjetër.

Puna në grup kërkon më shumë kohë për tu organizuar se puna në çift, sidomos në fillimin e veprimtarisë dhe në fund të saj.

Përfundimisht theksohet që, si pjesë përbërëse e metodologjisë së mësimit, këto forma të organizimit të mësimit me grupe, ndihmojnë në efikasitetin e punës së mësuesit dhe në krijimin e të nxënësve krijues e konstruktiv të nxënësve.

Matrica e cilësisë në arsimin profesional

Përvojë e re austriake në arsimin e mesëm ekonomik

Projekti i shkollave ekonomike AL-BIZ mbështetet në reformën tërësore të arsimit dhe në rritjen e përmirësimit të cilësisë dhe interesit për arsimin profesional, në drejtimin e kualifikimit të shkollave ekonomike. Ky projekt synon në forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve shkollë-biznes, si dhe rëndësinë e tregut të punës në arsimin e mesëm ekonomik në Shqipëri, si një prej elementeve më të rëndësishëm të sigurimit të cilësisë në shkollë.

Arritja e këtij qëllimi do të mbështetet edhe nëpërmjet një menaxhimi shkollor të përmirësuar, që e vë theksin në zhvillimin dhe sigurimin e cilësisë në shkollë. Nëpërmjet një komunikimi të përmirësuar e më intensiv, bashkëpunimi me biznesin dhe me ekonominë, profilet dhe kompetencat profesionale të tyre do të bëhen më të qarta. Në zbatim të një prej komponentëve më të rëndësishëm të projektit, "Zhvillimi dhe sigurimi i cilësisë në shkollë", u organizua një seminar një javor në datat 3 – 5 maj në Elbasan dhe në datat 6 - 8 maj në Vlorë, në të cilin morën pjesë përfaqësues të drejtorive arsimore, drejtues dhe mësues të shkollave ekonomike të përfshirë në projektin Alb-Biz, me ekspertin e ardhur nga Austria zotin Manfred Ashikuba. Eksperti austriak me përvojën e tij shumë vjeçare në Austri, sollti një model të ri të menaxhimit të cilësisë brenda shkollës apo e quajtur ndryshe, vlerësimi i brendshëm, duke u mbështetur tek zhvillimi i cilësisë për çdo shkollë pjesëmarrëse dhe zbatim masash për sigurimin e cilësisë brenda saj.

Ç'është matrica e cilësisë?

Matrica e cilësisë është një instrument i rëndësishëm për planifikimin e qëllimeve afatmesme të zhvillimit dhe të zbatimit të tyre në shkollë. Ajo përfshin një periudhë kohore 3-5 vjet. Qëllimet e një planifikimi të mirë dhe me "zgjuarsi" duhet të jenë të specifikuar, të matshme, tërheqëse, reale dhe të përcaktuara në kohë. Në lidhje në këtë parashikohen masa konkrete për zbatimin dhe përmirësimin e tyre, të cilat përfshijnë një koncept vlerësimi që orientohet nga indikatorët.

Analiza e potencialeve të shkollës apo planifikimi i zhvillimit dhe i zbatimit, fillon me:

- përcaktimin e vendndodhjes,
- analizën e potencialeve të shkollës,
- analizën e mjedisit shkollor, në bazë të proceseve kyçe/ arsimore.

Në analizën e potencialeve të shkollës bëjnë pjesë tre kompo-

Etleva Kaçuli - AKAFP

nentë të rëndësishëm që janë: (i) buxheti, (ii) personeli dhe (iii) infrastruktura. Të gjitha këto janë të lidhura ngushtë me matricën e cilësisë. Pikat e forta dhe të dobëta të faktorëve specifikë shkollor lidhen me shanset dhe rreziqet e mjedisit shkollor.

Programi i kontrollit dhe i zhvillimit, në të cilin bëjnë pjesë përcaktimi i qëllimeve afatmesme për zhvillim dhe zbatim, është i rëndësishëm në këtë proces. Ato i japin përgjigje pyetjes se cilat do të jenë pikat kyçe në të ardhmen dhe se si duhet të zbatohen ato. Në qëllimet afatmesme të zhvillimit, së pari zënë vend qëllimet vjetore për vitin aktual shkollor, ku përcaktohen veçanërisht edhe qëllimet vjetore për menaxhimin e cilësisë.



foto nga seminari një javor në datat 3 - 5 maj në Elbasan

Menaxhimi i cilësisë është një sistem përmbledhës i menaxhimit në nivelin e sistemit shkollor. Si i tillë, kërkon të zbatohen disa detyrime ligjore si norma, ligje apo rregulla, hapësira të lira organizimi gjatë punës pedagogjike, rrethin e rregullave të cilësisë (planifikimi, kryerja, kontrolli, veprimi), ku çdo objektiv të mendohet si një projekt më vete me detyra, afate, rreziqe dhe të interesuarit. Çdo objektiv është i lidhur ngushtë me pesë fushat e cilësisë, si dhe me elementet e strukturës që janë qëllimet e cilësisë, përshkrimi i procesit, sistemi matës, vlerësimi dhe feedback-u.

Vlerësimi i përgjithshëm është një proces sistematik i cili kryhet nëpërmjet autoriteteve shkollore mbikëqyrëse, sipas një planifikimi dhe koordinimi, për të kontrolluar cilësinë e institucionit arsimor dhe si rrjedhojë për ta përmirësuar më tej, duke u bazuar në parimin e përmirësimit të vazhdueshëm.

Vlerësimi i brendshëm i shërben reflektimit vetjak në lidhje me proceset e arsimit dhe administrimit, brenda institucionit arsimor. Ai është një instrument i organizimit dhe i zhvillimit të shkollës që i shërben zhvillimit të brendshëm të cilësisë. Në fund të çdo viti shkollor, ekipi përgjegjës për menaxhimin e cilësisë

Matrica e cilësisë është një instrument i rëndësishëm për planifikimin e qëllimeve afatmesme të zhvillimit dhe të zbatimit të tyre në shkollë. Ajo përfshin një periudhë kohore 3-5 vjet. Qëllimet e një planifikimi të mirë dhe me "zgjuarsi" duhet të jenë të specifikuar, të matshme, tërheqëse, reale dhe të përcaktuara në kohë. Në lidhje në këtë parashikohen masa konkrete për zbatimin dhe përmirësimin e tyre, të cilat përfshijnë një koncept vlerësimi që orientohet nga indikatorët.

brenda shkollës, duhet të hartojë një raport të quajtur “Raporti i cilësisë”. Ky raport është instrumenti me anë të të cilit çdo vit dokumentohet zbatimi dhe aktualizimi i programit shkollor.

Vlerësimi i jashtëm shërben për sigurimin/garantimin e barazisë së arritjeve në arsim tek të gjithë ofruesit e arsimit profesional. Ai shërben për kontrollin e efektshmërisë, përgatitjen e vendimeve bazë për zhvillimin e mëtejshëm të një fushe shkollore apo drejtim kualifikimi, dhe pozicionimin ndërkombëtar për këtë drejtim kualifikimi.

Parimet kryesore mbi të cilat mbështet vlerësimin janë zbatueshmëria, objektiviteti, korrektësia, si dhe përshtatja me normat etike. Objekt vlerësimi janë si proceset në vetvete (p.sh organizimi i provimeve të kulturës së përgjithshme apo të kulturës profesionale) ashtu dhe rezultatet e punës pedagogjike dhe administrative (p.sh. rezultatet e nxënësve). Një element shumë i rëndësishëm në procesin e menaxhimit të cilësisë është dhe feedback-u, i cili merret nga të gjithë grupet e personave, të cilët mund të gjykojnë cilësinë e shkollës në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, d.m.th. nga nxënës, prindër, të diplomuar, mësues dhe ekspertë të fushës nga ekonomia.

Pesë fushat e cilësisë për shkollat profesionale sipas modelit austriak janë si më poshtë:

1. Rritja e profesionalizmit dhe kualifikimi/zhvillimi i personelit
2. Klima në klasë dhe shkollë
3. Menaxhimi i shkollës
4. Marrëdhëniet e brendshme dhe të jashtme (ndërkombëtarizimi)
5. Mësimdhënia dhe të nxënët

Në zhvillimin e mëtejshëm të komponentit “Zhvillimi dhe sigurimi i cilësisë në shkollë” të projektit, shkollat pilote do të hyjnë në një proces të ri vetëvlerësimi duke u bazuar në matricën e cilësisë me të gjithë elementet e saj. Kjo matricë do të zbatohet në përputhje me sistemin arsimor të vendit tonë. Shkollat do të ndërmarrin hapa konkret për të qenë të suksesshëm në këtë proces të ri. Ky proces është shumë i rëndësishëm për të gjithë ofruesit e AFP-së, pasi ai ndihmon në vlerësimin aktual të tyre si institucion arsimor, në identifikimin e problemeve në shkollë për përmirësim të mëtejshëm, si dhe nevojat për një zbatim të suksesshëm të politikave arsimore.

Vendi ku dëshiroj të jetoj - Kuçova ime

Vjollca KLLAPI

mësuese shkolla “28 Nëntori - Kuçovë

E quajtem projekt madhështor, të mrekullueshëm, të rrallë në llojin e vet, të gjithë ne që patëm fatin e mirë ta ndiqnim projektin e përgatitur nga nxënësit e klasave të pesta me temë: “Hapat e parë në qytetin tim” nën udhëheqjen e mësueses së talentuar, Xhuljeta Lala. Projekti është një sintezë e përgjithshme e lëndës së vendlindjes, zhvilluar për herë të parë në klasat V, në vitin shkollor 2009-2010, si kurrikul e re e këtij sistemi arsimor.

Kësaj lënde, ky projekt i dha një frymëmarrje të re, i konkretizoi njohuritë teorike të marra në procesin mësimor duke i bërë më të gjalla, më aktuale e më të qëndrueshme ato.

Nxënësit duke shkuar në çdo vend, në çdo institucion, në çdo objekt me rëndësi kulturore, në çdo komunë, duke e prekur çdo gjë nga afër u bindën për vërtetësinë dhe realitetin e kësaj lënde. Për ta vendlindja u be me e dashur, me e afërt, me e pazëvendësueshme .

Emocione dhe kënaqësi te papare na fali ky projekt. Shumë nga sytë e të pranishmëve u përloten disa herë gjatë transmetimit të filmit për Kuçovën, për vendlindjen e tyre të dashur. Disa prej tyre mbase nuk e njihnim dhe nuk ia dinin vlerat asaj, por nëpërmjet këtij projekti ata mësuan shumë, madje me mburrje thoshin “Jemi krenarë që jemi kuçovarë dhe që jetojmë në një qytet kaq të bukur”

Projekti “Hapat e parë në qytetin tim” ishte një projekt gjithëpërfshirës me një masë nxënësish 75 veta ku secili u ndie i barabartë dhe me përgjegjësi në detyrën e ngarkuar.

Projekte, ku përfshiheshin 28-32 nxënës të një klase janë zhvilluar edhe here te tjera në shkollën tonë, por një projekt kaq dimesional nuk është aplikuar. Pikërisht, këtu qëndronte dhe vështirësia dhe bukuria e këtij projekti.

Paraqitja me ngjyrën jeshile të komunës “Perondi”

për të simbolizuar fushën pjellore të saj, veshja e nxënësve me ngjyrë të verdhë për të paraqitur komunën “Kozare” dhe Bashkia “Kuçovë” me ngjyrë të bardhë, simbol i paqes i gëzimit, i haresë, ishte një tjetër zgjedhje e veçantë e projektit.

Ky projekt pati një sukses të paimagjinueshëm, këtë e shprehnin sytë e të ftuarve nga Bashkia, komuniteti i prindërve, kolektivi mësues- nxënës etj.

Ky sukses nuk do të arrihej pa përkushtimin e punën e palodhur, pasionin, mundin dhe përpjekjet e vazhdueshme të mësueses së lëndës së vendlindjes e cila gjatë gjithë punës së saj një- vjeçare e finalizoi në një shkallë maksimale këtë lëndë, nëpërmjet këtij projekti që do të mbetet në kujtesën e gjithsecilit. Urimet më të mira për këtë projekt mësuesve dhe nxënësve të klasave të pesta të shkollës “28 Nëntori” Kuçovë.



Me nxënësit e shkollave, Kuçovë

Urime në ditën e



Kënga e Abetares

**Abetare, Abetare,
Sillma diellin në dritare!
Lehtë, lehtë
e bukur, bukur,
Dora ime sa e lumtur;
Hap një faqe,
kthen një fletë,
Nëpër shkronja -
Bota vetë.**

**Rrjedh në fjalë plot kumbim
Gjuhë e lasht e vendit tim.
Me ty mendjen lartësoj
Me ty zemrën e gëzoj,
Bëhem zog e fluturoj.
Abetare, Abetare,
Ti je dielli në dritare.**

Autori: Xhevahir Spahiu



parë të shkollës!



Një mësues i mirë

Vjollca SPAHO

Për **Kombs** (psikolog dhe pedagog humanist) "Mësuesi i mirë është thjesht ndihmës i nxënësit": Më konkretisht ai e percepton kështu mësuesin:

1. Të njohë mirë lëndën.
2. Të jetë i vemendshëm dhe i ndjeshëm ndaj nxënësit.
3. Të besojë se nxënësit mund të mësojnë.
4. Të mendojë mirë për veten e vet.
5. Të besojë në rolin pozitiv të ndihmës.
6. Të përdorë metoda të ndryshme mësimdhënieje

Më e rëndësishmja është besimi ndaj nxënësve, zgjidhjet e tyre, ndjeshmëria ndaj nevojave sociale dhe emocionale të fëmijëve, emocionaliteti, të qenët pozitivë dhe të sinqertë.

Pesë Rrugë Për Të Fituar RESPEKTIN E Nxënësve

1. Qëndrueshmëria

Nxënësit kanë nevojë për një "shtyllë të fortë". Shpesh kjo shtyllë realizohet nga ai mësues, i cili i bën të qarta standardet që pret të arrihen nga nxënësit. Nëse nxënësi mëson të vetdisiplinohet, atëherë ai/ajo do ta mirëpresë dorën udhëheqëse të mësuesit të vet.

2. Drejtësia

Nxënësit i njohin si arsyet, si mosarsyet e një situatë të dhënë. Ata do ta admirojnë mësuesin që është i ndershëm me: zbatimin e rregullave, nxënësit dhe shokët e nxënësve.

3. Nxitja

Mësuesi që nxit ambiciet, aftësitë dhe imagjinatën e fëmijës fiton një mik. Secila sfidë duhet të jetë pak përtej arritjeve të fëmijës, por jo aq shumë sa sfidat këtij t'i duken të pamundura për t'i arritur. Dhe sfidën, mësuesi duhet ta shoqërojë edhe me një dozë inkurajimi.

4. Ndhikma

Quajeni shërbim ose shqetësim për nxënësin. Nxënësit presin që mësuesit të shqetësohen për shpjegim sa më të mirë të lëndëve mësimore. Ata presin që mësuesi ta shpjegojë qartë lëndën. Nxënësit e rritin respektin për mësuesin, nëse ky tregon interes të zgjuar për ndjenjat dhe për rezultatet e tyre.

5. Gëzimi

Fëmijët kanë nevojë të ndjejnë se të rriturit që i rrethojnë janë të besueshëm, kompetent dhe të gëzuar gjatë zgjidhjes së problemeve të jetës. Mbi të gjitha, ata respektojnë mësuesin që i përballon problemet me humor të mirë, besim dhe siguri. Prova finale për këtë është atëherë kur një mësues ka "rritje" në aftësinë e tij/saj për të bërë shaka dhe/ose për të qeshur me vetveten.

Pesë Rrugë Për Të Humbur Respektin e Nxënësve

1. Zhvendosja e përgjegjësisë

Sa herë që dërgoni një nxënës te zyra e drejtorit (apo kërcënoni ta bëni), ju e transferoni përgjegjësinë që ju është dhënë te një person tjetër. Pra, hiqni dorë nga përgjegjësia për nxënësin që ju është besuar. Si pasojë, ju do të keni një influencë më të dobët te fëmija.

2. Kërcënimi

Kërcënimi vendos një çmim për mosbindjen. Nëse kërkohet që nxënësit ta paguanë këtë çmim, atëherë ata nuk binden. Kështu që, i paracaktuar për të rrënjosur frikë, kërcënimi dështon për t'u kthyer mendjen nxënësve të sillen ndryshe. Atëherë, ai që kërcënon ka telashe. Sepse, nëse kërcënimi nuk realizohet, autoriteti dobësohet. Nëse e realizoni kërcënimin, atëherë jeni i humbur.

3. Mungesa e konsekuencës

Një mësues nuk është konsekuent nëse dënon një nxënës për një shkelje dhe nuk dënon nxënësin tjetër për të njëjtën shkelje. Mungesa e konsekuencës gjithmonë është e shoqëruar me padrejtësinë dhe pavendosmërinë.

4. Shfaqja e temperamentit

Mësuesi, i cili i lejon emocionet e tij të shfaqen sa herë që gjërat nuk ecin mire, ka rrezik të humbasë respektin e nxënësve. Nxënësit kanë pak respekt për mësuesin që "s' di ç'bën" ose është i paparashikueshëm.

5. Nënvlleftësimi

Të nënvlerësosh një fëmijë, punën, shokët, qëllimet e tij/saj - kaq mjafton për t'u zvogëluar në sytë e fëmijës. Nënvlleftësimi mund të marrë shumë forma - më e keqja prej tyre është të dënosh nxënësin në sytë e shokëve të tij/saj.

Në librin e tij me titull "Ditën që rrojta unë ... (gazetari dhe eseisti), duke bërë fjalë për profesionin, Petro Marko shkruan: "Profesioni nuk është heroizëm. Është diçka më tepër dhe më njerëzore se heroizmi. Është detyrë."

Duket se afro pas një shekulli kur është shkruar, gjykimi ynë nuk ka ndryshuar shumë për çdo profesion e në veçanti për atë të mësimdhënësit. Ndoshta, thellë-thellë, shumë njerëz mendojnë se mësimdhënia nuk është profesion aq i vështirë. Por shumica e njerëzve janë të sigurt se mësimdhënia është një profesion dhe se ajo është një nga punët më të rëndësishme e fisnike, në të cilën një individ mund të shërbejë.

Në fakt, mësimdhënia ka qenë mbushur me fisnikëri e dedikim qëllimi nga filozofët, poetët dhe udhëheqësit politikë qysh në kohët e lashta.

Çfarë profesione të tjera kanë frymëzuar komente të tilla si këto?

“Çfarë profesioni fisnik është i vleshëm për shtetin sesa ai i njeriut që edukon brezin që rritet?” Cicero.

“Arsimi e bën një popull të lehtë për të udhëhequr, por të vështirë për ta drejtuar, të lehtë për ta qeverisur, por të pamundshëm ta skllavërosh” Lord Brougham.

“Njeriu që mund t’i thjeshtojë gjërat e vështira është mësuesi” Ralph Valdo Emerson.

“Në tavolinë ku unë qëndroj kam mësuar një të vërtetë të madhe. Përgjigja për të gjitha problemet tona kombëtare-përgjigja për të gjitha problemet e botës-vërtitet në një fjalë të vetme. Ajo fjalë është arsimi.” Lindon Xhonsan

“Në qoftë se ka profesion që nuk qas njerëz të vegjël e pa ideal, ky asht profesioni i mësuesit.” Aleksandër Xhuvani.

“Profesioni i mësuesit është: zbavitës, sfidues i vështirë, ekzistues, i tmerrshëm, përzgjedhës. Profesioni i mësuesit është të mësosh vetë, të kujdesesh, të rritesh, të ndihmosh të tjerët, t’i lehtësosh ata, të lodhesh vetë, të kesh përvojën e profesioneve të ndryshme, të tregosh sa i anshëm dhe i paanshëm je realisht, të marrësh vendime, të zgjerosh njohuritë, të pranosh të krijosh, të ndërtosh, të jesh në lartësi të natyrshme, të gjallërosh mësimin, të shpërblesh, të shqetësohesh, të luash rolin sipas modelit, të ndihmosh të tjerët, të ndjehesh mirë, të organizosh e të planifikosh..” Nga ditari i një mësueseje.

Pavarësisht nga këto përkufizime, historikisht ka ekzistuar një informacion i vogël i konsoliduar rreth artit të mësimdhënies me nivel të lartë.

E megjithatë, një është qëllimi final i mësuesit; “ të ndikojë në jetën e nxënësve pavarësisht nga prejardhja e tyre dhe të formojë qytetarë, të cilët mund të jetojnë dhe të punojnë me produktivitet në një shoqëri me një dinamizëm



kompleks në rritje ”.

Kjo gjë po ashtu nuk është e re. E re është të kuptuarit e faktit se për ta bërë këtë gjë, mësuesit duhet të përfshihen në proces të vazhdueshëm rinovimi dhe ndryshimi. Të bësh ndryshime në një botë që është vazhdimisht në ndryshim, do të thotë të ndeshesh dhe të menaxhosh forcat e ndryshimit të vazhdueshëm.

Shoqëria kërkon që qytetarët e saj të jenë të aftë të orientojnë dhe të menaxhojnë ndryshimet gjatë gjithë jetës, si individualisht, ashtu edhe në bashkëpunim me të tjerët, në një kontekst të transformimeve dinamike, globale, shumëpalëshe. Për t’u bërë ekspert në dinamikën e ndryshimit, mësuesit duhet të bëhen agentë me përvojë të ndryshimit. Sot puna e mësuesit është më komplekse se kurdoherë. Ata duhet t’u përgjigjen nevojave të një popullate nxënësish, që është e larmishme dhe në ndryshim, ndryshimeve të shpeshta të teknologjisë dhe kërkesave për cilësi, ndryshimeve të vetë shoqërisë e cila, siç dihet, është në ndryshim të vazhdueshëm.

Me qëllim që të ruajmë besimin dhe motivimin në këtë periudhë përtëritjeje dhe ndryshimi, rezultatet nga angazhimi i gjithsecilit punonjësi të arsimit duhet të jenë të dukshme - **jo në pak vite**, por këtu dhe tani. Një dijetar i mençur, njëherë, ka thënë se **“çdo gjë reziston përveç ndryshimit”** dhe ky paradoks është një karakterizim adapt për profesionin e mësuesit.

Për të qenë një mësues i suksesshëm, mësuesi duhet t’i përshtatet novacioneve në arsim. Megjithëse është e vështirë të parashikohet natyra e saktë e ndryshimit të ardhshëm, është me vlerë të fillosh të mendosh mbi atë qysh tani. Duke shqyrtuar e studiuar zhvillimet e sotme të arsimit, secili mund të krijojë mundësi për të depërtuar në ndryshimet, përballë të cilave do të ndodhet në vitet në vazhdim.

Përdorimi i Kamishibait si mjet didaktik dhe integrues

Ç'është kamishibai?

Kamishibai është mjet didaktik shumë i rëndësishëm. Rrjedh nga fjala japoneze Kami që do të thotë letër dhe shibai teatër. Historia e tij është e lidhur ngushtë me traditën e artit dhe pikturës në Japoni qysh në shekullin e VIII-të. Ka origjinë nga spektakli i rrugëve. Në fillim e përdorën budistet për konvertimin e fshatarëve duke bartur korniza druri dhe ndërruar pikturat me përmbajtje fetare dhe politike. Format e para të tij ishin të rënda për transport, megjithatë kjo teknikë ka zënë të përdoret për gjatë tre shekujve. Në vitet '30 kur Japonia përjetoi një krizë të madhe ekonomike, ishte bërë pjesë e pandarë e shoqërisë si mjet zbavitës për masën.

Njeriu "kamishibai" nëpër rrugë e sheshe rrëfente përralla me ndihmën e një mjeti të thjesht didaktik, zakonisht të vendosur në pjesën e prapme të biçikletës, duke ndërruar vet vizatimet. Shfaqja bëhej falas, por ai fitonte duke shitur bonbone për fëmijë. Më vonë (1950) u zëvendësua nga televizori, aktiviteti i tij si teatër fotografish zhduket krejtësisht. Rrëfyesit e spektakleve të rrugëve u zëvendësuan me tregues të përrallave për fëmijë.

Përdorimi i tij mbetet në struktura tjera pedagogjike si: në bibliotekë, institucione parashkollore, në shkollë, në spital-pediatri etj., harmonizohet natyrshëm në shumë projekte mësimore. Duke filluar nga personat analfabet që mundëson deshifrimin e fotografisë si etapë hyrëse apo parapërgatitore e gjuhës së shkruar. Ai është një mjet ndihmës për të mësuar leximin sipas mënyrës ludike. Sidomos tek nxënësit e dobët nxit dëshirën për të lexuar.

- Në para shkollorë përdoret për ta treguar përrallën.
- Në shkollë fillore mësimdhënësit e pasurojnë aktivitetin e tyre arsimor në disa lëndë: letërsi, biologji, histori etj. në festa me prindër e gjerë te projektet integruese me nxënës dygjuhësor, projekte integrues për të rinj etj.

Aktualisht në Japoni ka një përdorim shumë të gjerë. Arritja e tij në Evropë është diku rreth viteve '70-të. Në Zvicër është pjesë e inventarit të shkollës, pjesë e orës së mësimi, sidomos në arsimin parashkollor.

Kamishibai apo teatri i vogël është i sajuar nga druri, ka formën e një valixheje të vogël udhëtimi me dimension 45 x 36 x 7,5 cm. Vendoset mbi tavolinë, në parvazin e tij vendosen vizatimet me tekstin e përrallës. Pjesa e përparme (ana nga publiku) është e mbyllur me tre kapak të cilët hapen që në fillim të punës për të u dukur faqja e ilustruar. Fletët e ilustruara ndërrohen çdo herë me shkathtësi nga mësuesi/ja apo nxënësit.

1. Tregimi i përrallës për mes Kamishibait Prezantimi

Nexhmije MEHMETAJ, mësuese në Zvicër

i ngjarjes bëhet duke ruajtur ritmin e leximit dhe kalimin e vizatimeve. Zgjedhja e përrallës duhet të ketë një moment dhe pritje me ankth që zhvillon imagjinatën e fëmijës. Materiali i nevojshëm është mjaftë i thjeshtë: Një dosje pedagogjike e vendosur në një "kornizë druri" e shoqëruar me 8-12 vizatime të madhësisë A3- 42 x 29,7 cm.

Krijimi i vizatimeve

• Krijimi i vizatimeve bëhet sipas ndarjes së ngjarjes. • Ato bëhen në letër të trashë, të ngjyrosura mirë me ngjyra të gjalla, mbështillen me letër të tejdukshme. Vizatohen elemente të rëndësishme të tekstit. Ngjyra që shihen mirë. Vizatime të mëdha pa detaje të vogla.

• Në pjesën e prapme të vizatimit vendoset teksti i shkruar sipas kësaj mënyre: (nëse tregimi është ndarë në 8 pjesë), vizatimi numër 1, i përgjigjet tekstit numër 8, vizatimi 2 – teksti 1, vizatimi 3 teksti 2,.....

Në rast se përralla tregohet në mesin dy gjuhësorë atëherë teksti përkthehet dhe vendoset në të dy gjuhët.

Përgatitja e leximit.

• Leximi i përrallës përmes Kamishibait, lidhet shumë me aftësitë parapërgatitore të orës mësimore duke qenë model para nxënësve.

• Teksti lexohet në mënyrë dramatike nga mësuesi/ja e cila rri për ballë fëmijëve duke krijuar gjallëri para tyre, ndërsa nxënësit vendosen në formë harku.

• Me këtë kuptohet që ata do ta dëgjojnë mësuesin/en, duke lexuar me zë të lartë pjesë të zgjedhura, duke krijuar një atmosferë të këndshëm të leximit, që i bën nxënësit të vëmendshëm dhe i tërheq ta vështrojnë atë si një shembull cilësor.

• Para pëlqehet që për leximin me zë të lartë përpara klasës të zgjidhen pjesë të shkurtra të përrallës, për ta ndarë me ta gëzimin e kënaqësinë gjatë leximit.

• Të lexuarit me zë të lartë nga pjesët e zgjedhura si nga përmbajtja dhe gjuha e mban të përqendruar vëmendjen e nxënësit e zhvillon imagjinatën dhe ndihmon për të krijuar e forcuar aftësitë dhe shprehjet:

- Të themi dhe të dëgjojmë
- Të kuptojmë dhe të prodhojmë një mesazh gojor, që tregon.

- Të adaptojmë nivelin e gjuhës sipas dëgjuesit.

- Duke dëgjuar me dëshirë leximet e mësuesit, nxitet dëshira për të mësuar gjëra interesante dhe rritet kurioziteti i tyre..

Metodologjia: Mësimdhënia, leximi i një përralle përmes një mjeti të ri që nuk do të jetë libri. Në këtë aspekt pjesa që do të lexohet para nxënësve mësuesi/ja për ta interpretuar si duhet teksti duhet ditur gati përmendsh. Nxënësit presin me dëshirë t'u flitet për vendndodhjen e ngjarjes, të njihen me titullin e përrallës që do ta gjejnë ata nëpërmjet vizatimeve. **Klasa:** e I - II-të kopshte shkollorë dhe klasa e parë shkollë fillore.

Kompetenca: Dëgjimi dhe të kuptuarit e përrallës. Të kuptuarit e funksionit të Kamishibait.

Tema: Përrallë shqipe, etj. **Madhësia e grupit:** 26 nxënës. **Koha e kërkuar:** 45min. **Objektivat** • Të njihen nxënësit me një ngjarje të re. • Të përqendrohen në kuptimin e përmbajtjes. • Të pasurojnë fjalorin me fjalë e shprehje të reja.

Organizimi orës.

Hapi parë, nga 5-15 min. për prezantim. **Hapi i dytë**. Nga 10-15 min. Leximi i përrallës. **Hapi i tretë**. Nga 15-20 min analiza e përrallës.

2. Projekt leximi përmes kamishibait, nga mësuesit që punojnë dy me dy (dy mësues me dy klasë të njëjta). Prezantimi i projektit nxënësve të dy klasave. Paraprakisht të krijohet një tregim me nxënës. Fillimin e tregimit e bëjnë mësuesit kurse zhvillimin dhe fundin e bëjnë nxënësit. Propozohet titulli, shkruhet teksti, korrigjohet me ndihmën e fjalorit. Ndahet në pjesë. Bëhen vizatimet sipas ndarjes së ngjarjes. Përgatitja e leximit, çdo nxënës ushtron leximin dhe përdorimin e mjetit. **Vetëvlerësimi**, grupet e nxënësve prezantojnë tregimin nxënësve të klasës. Takohen nxënësit e dy klasave prezantojnë dy tregime të krijuara prej një fillimi të njëjtë por me një përfundim të ndryshëm. Prezantimi në klasë tjera të shkollës jo më shumë se 50 nxënës. Prezantimi para prindërve me rastin e përfundimit të vitit shkollor.

3. Projekt leximi për mësuesit e shqipes jashtë atdheut Nga përvoja konstatohet se ky mjet didaktik është edhe mjet integrues. Shembulli vjen nga Zvicra në kantonin Jura projekti “Kamishibait” ishte mjaft i suksesshëm përralla “Fitorja e milingonave” u mirëprit në 40 klasë të shkollës zvicerane (30 komuna).

Prezantimi i një libri nga letërsia shqipe për fëmijë, një



tregim apo një përrallë e zgjedhur nga mësuesit që punojnë në mësimin plotësues të gjuhës shqipe jashtë atdheut, në bashkëpunim me një mësues/e në vendin ku ata jetojnë.

Objektivat:

- Të përkrahet shumë gjuhësia për mes leximit.
- Të njihet gjuha amtare e nxënësve.
- Të përforcohet lidhja mes gjuhës amtare dhe gjuhës së shkollës.

• Të përmirësohet kompetenca e gjuhës së dytë për mes njohjes së gjuhës së parë.

• Të favorizoi hapjen e nxënësve një gjuhësor në panoramën e gjuhëve tjera.

• Të njehet kultura dygjuhësore e nxënësve

• Të përkrahet aftësia bashkëpunuese.


Projekti t'i prezantohet Këshillit të arsimtarëve të shkollës ku punohet. Paraprakisht të përkthehet në gjuhë të vendit të qëndrimit për të krijuar mundësinë e vlerësimit nga shkolla.

Organizimi orës.

Hapi parë, nga 5-15 min. bashkëbisedim për vendin e origjinës së përrallës për Shqipërinë, gjuhën shqipe. Hapi i dytë . Nga 10-15 min. Leximi i përrallës. Hapi i tretë. Nga 15-20 min analiza e përrallës.

Mësuesi vullnetar i vitit 1942 në Kosovë

Nga Ismet LLAPUSHI



Në 6 Shtatorin e këtij viti shkollor, mësuesi veteran Ryzhdi Guranjaku, do të mungonte në ceremonitë promovuese të ditës së parë të shkollës. E kishte bërë zakon që, ndonëse në pension, zilen e parë të cdo viti të ri shkollor, ta dëgjonte në një nga shkollat më të afërta ku gjendej. Dhe kjo e

ripërtërinte, i jepte jete, por vitet e moshës bëjnë të vetën. Ai u nda nga jeta 3 javë para 6 Shtatorit të këtij viti, në qytetin ku banonte, në Kavajë, në moshën 91 vjecare. Një nga miqtë e tij, mësuesi veteran, publicisti dhe shkrimtari elbasanas Hyjni Ceka shprehet: “Tipar dallues i Ryzhdiut ishte dashuria për njerëzit, vecanërisht dashuria e madhe për nxënësit. Prandaj ai, sot e kësaj dite, qëndron i respektuar në kujtesën e tyre dhe të kolegëve jo vetëm të Elbasanit e fshatrave për rreth, por te të gjithë ata që e njihnin. Ai iku pa kthim në fillim të këtij viti shkollor, me një pamje të pa arritshme, shtatëlartë, me sy të qeshur që rrezatonin mirësi dhe përzemësi”.

Për këtë mësues veteran dhe patriot kemi shkruar disa rreshta edhe para 7 vitesh, me rastin e 7-Marsit, atëherë kur sëmundja kishte nisur ta ngacmonte dhe t'ia rëndonte peshën e viteve te pleqerisë. Episodet e jetës të Ryzhdiut, si atdhetar e mësues, janë të pafundme. T'i renditësh ato, do të duhen faqe te tëra, ku nuk kanë munguar mendimet për atdheun, për Kosovën, për probleme të arsimit si dhe mjaft krijime letrare.

Ka lindur në vitin 1919 në qytetin arsimdashës të Elbasanit, ndërsa për mbi 40 vjet ka punuar e jetuar në qytetin e Kavajës. Ryzhdiu ishte i biri i një familjeje të shquar për atdhetarizmin dhe arsimdashës, vëllai i MËSUESIT TË POPULLIT, i letrarit dhe dëshmorit Qamil Guranjaku, emrin e të cilit mban sot një nga shkollat e qytetit të Elbasanit. E ka nisur profesionin e tij si

mësues, jashtë trojeve tona, në Kosovë dhe më pas ka shërbyer në tërë krahinat e Shqipërisë. Sipas mësuesit Bilbil Gjoni dhe kolegëve të tij, ai ka qënë njeri me interesa të gjera dhe ka dhënë kontribut të rëndësishëm me shkrime, artikuj e letra drejtuar miqve të tij për të bërë të njohur Kosovën, si dhe për të dhënë përvojë në lëmin e arsimit. Në shënimet e tij, nga shërbimi në Kosovë, shkëputim këto rradhë:

“Ishim 200 mësues të sapodiplomuar nga Normalja. Më 15 Janar 1942 u nisëm për në Kosovë, ku do të hapnim dyert e shkollave në gjuhën shqipe. Pasi udhëtuam 10 ditë në atë dimër të egër, arritëm në Prishtinë. U caktova të punoj në një nga shkollat fillore të këtij qyteti. Bashkë me mua ishin edhe mësuesit: Rexhep Dizdari, Sali Morina, Abdyl Myzyri, Kamber Xheria, rektori Vasil Andoni, drejtori i konviktit Ahmet Gashi dhe kujdestari Kico Kasapi. Qarqet e ndryshme shoviniste serbe na pengonin në cdo hap të punës sonë. Synimi i tyre ishte mos shkollimi i qytetarëve të Kosovës dhe mos mësimi i gjuhës shqipe prej tyre. Ndonëse në kondita të vështira, ne nuk u tërhoqëm për asnjë cast nga misioni ynë. Pas një viti shkollor në Prishtinë, transferohem në fshatin Godime të Ferizajt. Me mësuesin tjetër elbasanas, Kadri Greca, punonim në 4 klasa ditën, ndërsa natën u mësonim shkrim e këndim të rriturve.

Në pushimet verore të vitit 1943, kthehem në Elbasan. Zëri i clirimit të atdheut më thërret edhe mua. U bashkëngjitem formacioneve partizane. Pas clirimit, me pasion, nisa profesionin e mësuesisë. Punova deri në vitin 1974 kur dhe dola në pension. Në shënimet e Ryzhdiut, me nostalgji flitet për fshatin Godime të Ferizajt dhe banorët e tij. Me emocionin e një të moshuari aty gjen fjalë dashurie dhe respekti për ish nxënësit e tij nga Godima si: Rexhep Ejupi, Ramush Ejupi dhe Fehmi Ejupi, të cilët i kishin bërë një vizitë në shtëpi atij në fillim të demokracisë. Duke përfunduar me këto mbresa, shënojmë se me ndarjen nga jeta të Ryzhdi Guranjakut, mbyllet jeta e 200 mësuesve që u dërguan për të punuar jashtë trojeve tona.

Le të jenë këto rreshta një Homazh nderimi për të gjithë ata 200 kolegë të tij.

Mësimi plotësues në gjuhën shqipe në diasporë

Një vështrim përmes punimeve të një seminari

Besnik RAMA

Specialist në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës, Tiranë

Në datat 26-28 korrik 2010, në Vlorë zhvilloi punimet Seminari VI Mbarëkombëtar me mësues të mësimit plotësues në gjuhën shqipe në diasporë, bashkëpunim midis Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës të Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës e Teknologjisë të Kosovës. Seminari kishte si qëllim trajnimin e mësuesve që u japin mësim fëmijëve emigrantë shqiptarë në diasporë, si dhe njohjen me përvojat më të mira të shkollave shqipe të mësimit plotësues në Angli, Greqi, Itali, Suedi, Gjermani, Finlandë etj.

1. Kronikë informuese

Fëmijët e Qendrës Kulturore Vlorë dhanë një koncert të pasur me këngë, valle e recitime. Pas fjalës së hapjes nga mësuesja M. Berishaj - Tëulen, Austri, të pranishmit në seminar i përshëndeti zëvendësministri i MASHT, zoti A. Hyseni. Sipas programit, gjatë seancave plenare u mbajtën ligjërata për mësimdhënien dhe të nxëniet, për barrierat gjuhësore për fëmijët emigrantë dhe mënyrat e shmangies së tyre, për identitetin etnik dhe mësimin e gjuhës amtare, për artet pamore në funksion të mësimit plotësues, për përvoja dhe alternativa të modelimit të kampionateve dhe konkurseve etj. Puna tematike në grupe trajtoi probleme që lidhen me: planifikimin si kusht i suksesit të mësimit plotësues në gjuhën shqipe; hulumtime rreth përfshirjes së nxënësve; përvoja nga testimet në lexim në Suedi etj.

Montazhi filmik, realizim profesional i znj. Greta dhe i z. Arian Melonashi, me episode nga punimet e seminarit të kaluar, me intervistat, diskutimet dhe vizitat në vende historike, kulturore etj., risolli në kujtesën e shumë pjesëmarrësve mbresat e pashlyera nga ditët që kishin kaluar në Mitrovicë.

Gjatë pasditeve, me mbështetjen e DAR-së Vlorë dhe në kujdesin e specialistes së arsimit, zonjës Tefta Caushaj, pjesëmarrësit në seminar vizituan në mënyrë të organizuar Shtëpinë-muze ku u shpall Pavarësia e Shqipërisë, Manastirin në Zvërnec, Kuz Babanë, plazhin e Orikumit dhe Tragjasin. Seminaristët patën kështu rastin të shohin nga afër monumente kulture, pika turistike dhe vende historike, për të cilat kishin mësuar e dëgjuar jo pak nga historia e nga burime të tjera informacioni.

2. Vlerësime për seminarin me mësuesit e gjuhës shqipe në diasporë

Seminari i Vlorës ishte tregues i punës serioze që bënë dy ministritë, ashtu si për tri seminarin e mëparshme të përbashkëta. Mësuesit e diasporës që marrin pjesë në seminarin trajnues, shkëmbejnë përvoja të tyre; mësojnë nga njëri-tjetri; kualifikohen përmes ligjëratave që mbahen nga specialistë e didaktë të njohur, nga Shqipëria e Kosova, të fushave të mësimdhënies dhe të të nxëniet; diskutojnë e gjejnë zgjidhje për mjaft nga problemet që hasin në punën e tyre me fëmijët emigrantë. Seminarin e

përvitshme po shërbejnë dhe për publikimin e botimeve (libra apo fletëpalosje) të stafëve pedagogjike, forumeve, shoqatave apo individëve. Në këto botime pasqyrohen veprimtaria mësimore dhe aktivitetet e ndryshme me fëmijët emigrantë, si dhe shkruhet për figura mësuesish shqiptarë që japin ndihmesën e tyre të pakursyer në diasporë.

Sa më të vjetra janë mërgatat tona në Evropë, aq më të hershme janë shkollat shqipe që u ofrojnë fëmijëve emigrantë mësimin e gjuhës amtare dhe të kulturës shqiptare si shprehëse të identitetit kombëtar. Është shumë domethënëse fakti se interesi i emigrantëve shqiptarë për armimin e fëmijëve të tyre në gjuhën amtare vjen e rritet. Janë për t'u përshëndetur shtimi e zgjerimi i shkollave shqipe, rritja e numrit të fëmijëve që ndjekin mësimin shqip, iniciativat vullnetare të forumeve, shoqatave e biznesmenëve, si dhe shërbimi i mësuesve emigrantë që, në shumicën e rasteve, është vullnetar e pa shpërblim.

Edhe pse shkollat shqipe të mësimit plotësues (ShShMP) në gjuhën shqipe në diasporë janë produkt i iniciativave dhe i vullnetarizmit, dy ministritë e arsimit prej vitesh janë të angazhuara për t'i mbështetur mësuesit, nxënësit dhe të gjithë aktorët e tjerë të përfshirë në ofrimin e shërbimit për mësimin e gjuhës shqipe në diasporë. Seminarin e përvitshme janë vetëm njëri nga treguesit konkretë të këtij angazhimi. MASHT e Kosovës, që në nëntor të vitit 2007 ka hartuar dhe publikuar kurrikulën e shkollës shqipe të mësimit plotësues në diasporë. ShShMP-së në diasporë i janë rekomanduar tekste e literaturë për përdorim nga mësuesit, nxënësit e prindërit. Janë bërë hapa konkretë dhe për hartimin e teksteve të posaçme për fëmijët tanë në diasporë. Është përgatitur libri i parë që përfshin paraabjetaren dhe gjashtë fletore didaktike. Ky libër (në 7 lidhje të veçanta), së shpejti, do të shtypet në 5000 kopje dhe do të ndahet falas nga MASHT. Do të vijojë puna për harmonizimin e detyrave për hartimin e librave 2 dhe 3.

Materialet e çdo seminari që zhvillohet me mësuesit e diasporës, botohen në përmbledhjen "Shkolla për gjuhën dhe kulturën e Atdheut dhe identiteti kombëtar". Grupi i punës i ngritur nga MASH-i sapo ka përfunduar hartimin e Programit të integruar të mësimit shqip në diasporë. Programi integron njohuritë për zotërimin e gjuhës amtare me njohuri për historinë kombëtare, gjeografinë dhe trashëgiminë.

3. Disa probleme që kërkojnë më shumë vëmendje në të ardhmen

Në ShShMP janë aktivizuar mësues të kategorive të ndryshme, të cilët, njëherësh mbartin dhe përvoja e nivele aftësish profesionale të ndryshme. Shkëputja prej vitesh nga të dhënëti mësim, apo mosshtrimi i profesionit të mësuesisë që prej diplomimit e përballin mësuesin e ShShMP-së me vështirësi që nuk kapërcehen me lehtësi, sidomos po të kemi parasysh punën me fëmijë të moshave e nivele të ndryshme në një mjedis, punë që ka veçori në krahasim me klasën që përfshin një grupmoshë dhe një program të përbashkët. Nisur nga ky realitet që ekziston në ShShMP-të në diasporë, seminarin mbarëkombëtar kanë vlera të pamohueshme, se i shërbejnë riformimit të mësuesve emigrantë të angazhuar në mësimin plotësues në gjuhën shqipe. Por në seminarin, si pasojë e aplikimeve private, pranohen dhe individë që drejtojnë shoqata apo organizata që kanë fare pak lidhje (ose nuk kanë lidhje) me mësimin e gjuhës shqipe në diasporë. Dhe këta nuk janë pak. Ose,



në vend të mësuesve që kanë nevojë të trajnohen, vijnë drejtues forumesh e shoqatash apo biznesmenë që mbështesin shkollat (kurset) shqip. Në asnjë rast nuk është bërë përzgjedhje selektive e mësuesve, as mbështetur në specialitetin ku janë diplomuar. Këto janë dy nga arsyet që prej një pjese të seminaristëve mungon interesi për të ndjekur të gjitha seancat apo për të qenë aktivë gjatë seminarit. Me këtë nuk dua të injoroj aspak kontributin që japin në seminar shumica e mësuesve pjesëmarrës, të cilët shpallorin arritjet e tyre në vendet ku kryejnë aktivitetin si mësues, si dhe pasurojnë me ide e alternative efektive tematikën e problemeve që trajtohen gjatë ditëve të seminarit.

Edhe pse nuk jemi në hapat e parë të hapjes dhe të funksionimit të ShShMP-ve në diasporë, nuk ekzistojnë të dhëna zyrtare për nivelin e shkollimit dhe për kompetencat profesionale që kanë mësuesit pjesëmarrës në seminarët që organizojmë. Më tej, mungojnë të dhënat për mësuesit që shërbejnë në ShShMP. Nuk vë aspak në dyshim bankën e të dhënave që kanë drejtuesit e ShShMP-ve për mësuesit që kanë aktivizuar për të dhënë mësimin e gjuhës amtare, por mendoj se ka ardhur koha që, nëse bëhet fjalë për angazhim serioz në ofrimin e shërbimit arsimor për fëmijët emigrantë, stafet pedagogjike duhet të vlerësojnë thithjen, aktivizimin dhe përfshirjen e personave më të kualifikuar, sepse vetëm kështu do të mundësohet një shërbim cilësor dhe do të rritet besimi i prindërve në investimin që bëjnë edhe ata për arsimimin shqip të fëmijëve të tyre, për ruajtjen e kultivimin e gjuhës amtare dhe të kulturës kombëtare te brezi i ri që rritet e formohet jashtë atdheut. Ekzistojnë vetëm të dhëna të pjesshme për numrin e mësuesve dhe të nxënësve që ndjekin mësimin plotësues në gjuhën shqipe në emigracion. MASH-t e Kosovës ka kontakte dhe adresa të 400 mësuesve, kurse për numrin e nxënësve emigrantë të interesuar për mësimin plotësues në gjuhën shqipe, bazuar në raportime të mësuesve, shoqatave dhe forumeve në vende të ndryshme të Evropës, deklarohen shifra për rreth 30 000 fëmijë të përfshirë në shkolla e kurse.

Në seminarët ku trajnohen mësues të diasporës, veç palës shqiptare e asaj kosovare, nuk ftohen e nuk marrin pjesë aktorë të fushës së arsimit nga shqiptarët e Maqedonisë, të Malit të Zi, të Preshevës apo të diasporës sonë jashtë Evropës, ku ekzistojnë një historik dhe një përvojë shumë më e vjetër e përpjekjeve të shqiptarëve për të mbajtur të gjallë gjuhën amtare.

Është vendi për të tërhequr vëmendjen se këshillat e mësuesve, forumet, shoqatat, biznesmenët shqiptarë dhe aktorë të tjerë të interesuar për arsimimin e fëmijëve emigrantë nuk kanë ura lidhjeje dhe bashkëpunimi në dobi të misionit që kanë ndërmarrë kryesisht mbi baza vullnetare, përmes hapjes së ShShMP-ve e kurseve plotësuese në gjuhën shqipe. Shpesh, sidomos ata që veprojnë në Greqi, i kundërvihen njëri-tjetrit dhe kundërshtojnë njëri-tjetrin. Janë për t'u përshëndetur vullneti dhe pasioni i çdo individi apo organizate në fushën e hapjes dhe të konsolidimit të ShShMP-ve në vendet ku banojnë emigrantë shqiptarë, sepse përfaqësojnë me të vërtetë sakrificat në shërbim të ruajtjes së identitetit kombëtar. Ekzistenca dhe funksionimi i ShShMP-ve janë një nxitës më

shumë për të gjithë ata prindër e kujdestarë të fëmijëve në moshë shkolllore, të cilët, nisur nga mjedisi ku kanë shkuar, nuk i kushtojnë rëndësi mësimin të gjuhës amtare, me idenë se fëmija, duke mësuar gjuhën shqipe, mbetet prapa në përvetësimin e gjuhës së vendit ku janë, dhe të lëndëve të tjera të planit mësimor. Janë befasuese, por dhe shumë domethënëse rezultatet që kanë shënuar shumë nxënës emigrantë shqiptarë në testimet në lexim në shkollat publike në Suedi, të cilët, brenda një semestri kanë arritur që të ngjiten nga niveli 13 në nivelin 18. Tregues të tillë flasin dhe për aftësitë integruese që kanë fëmijët emigrantë shqiptarë.

Sipas të dhënave statistikore jo të plota, ShShMP-të në diasporë kanë më shumë masivitet dhe ndiqen nga moshat që u përkasin niveleve 1 dhe 2, d.m.th. klasave I-VI. Lipset që të marrin përparësitë që u takojnë dhe nivelet 3 dhe 4, respektivisht klasave VII-IX dhe X-XII. Të mos harrojmë se niveli 3 (klasat VII-IX) përfshin moshën e detyrimit shkollor. Në këtë kuptim, vazhdimi i mësimin plotësues në gjuhën shqipe nga fëmija është plotësisht i mundshëm, por dhe më se i domosdoshëm.

4. ShShMP në diasporë dhe MASH-i e MASH-T-i

Siç përmenda më lart, MASH-t e Kosovës do të shtypë e do të shpërndajë falas një sasi tekstesh në ndihmë të ShShMP-ve në diasporë. MASH-i, në përgjigje të kërkesave, ka furnizuar me tekste mësimore shkolla dhe shoqata emigrantësh, duke bërë më të mirën e mundshme. Por tekstet që u kemi dhënë atyre, u përgjigjen programeve të shkollës sonë publike. Për rrjedhojë, ato tekste nuk u kanë shërbyer si duhet nxënësve e prindërve, por as mësuesve në diasporë, sepse ata janë përballur me vështirësi, pasi nuk janë në gjendje të bëjnë përzgjedhjet dhe përshtatjet e duhura. Mësues të shquar etj., nisur nga nevojat e fëmijëve emigrantë, kanë marrë iniciativën dhe kanë hartuar e shpërndarë tekste e mjete të ndryshme mësimore, por, disa prej tyre e ndiejnë se nuk kanë arritur atë që duhet. Kjo ka ardhur nga fakti që, para hartimit të një teksti mësimor, duhet të ekzistojë një program i studiuar e i konceptuar në përshtatje me nevojat



e mundësitë reale që kanë ShShMP-të, fëmijët emigrantë dhe mësuesit në diasporë. Pikërisht, nisur nga këto kushte, MASH-i po shqyrton programin e integruar, për të vijuar me ftesën që do t'u bëjë didaktëve e autorëve më të zotë për hartimin e teksteve për fëmijët emigrantë. Mendoj se një tekst mësimor mjaft efektiv do të ishte ai që do t'u ofronte fëmijëve shqiptarë mësimin e gjuhës amtare njëherësh me gjuhën e vendit ku ata banojnë aktualisht. Megjithatë, alternativat që do të paraqiten, do të plotësojnë më së miri boshllëkun që ekziston.

MASH-i dhe MASH-T-i janë në dijeni të nevojave dhe të kërkesave të ShShMP-ve në diasporë. Ato janë të angazhuara që me plane veprimi konkrete të mbështesin konsolidimin e mësimin plotësues në gjuhën shqipe në diasporë.

Mbi menaxhimin në bazë shkollë

Përshtati: Vladimir PASKU/IKAP

Ndër shumë strategji që janë duke u zbatuar në vende të ndryshme të botës, e njohur është ajo e Menaxhimit në Bazë Shkollë. Thelbi i saj konsiston në decentralizimin e vendimmarrjes në arsim, nëpërmjet rritjes së përfshirjes së prindërve dhe të komunitetit në veprimtarinë e shkollave. E shndërruar në një lëvizje me përmasa globale, ajo ka përfshirë edhe zhvillimet e arsimit shqiptar.

Hyrje

Pavarësisht angazhimit të qeverive dhe agjencive ndërkombëtare për sektorin e arsimit, aksesit eficient dhe i barabartë në arsim mbetet ende iluziv për shumë njerëz në botë. Në shkallë globale, vëmendja e tyre ndaj këtyre problemeve shprehet në iniciativën “Arsimi për të gjithë”. Në shkallë lokale, tipik është “Programi i Bankës Botërore në vendin tonë “Cilësi dhe barazi për të gjithë”. Por, edhe kur fëmijët kanë akses për arsimim, cilësia e tij shpesh është shumë e ulët. Testimet ndërkombëtare, si ato në Programin për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA), tregojnë se shumica e nxënësve në vendet në zhvillim kanë rezultate të ulëta. Tashmë shihet qartazi se, në mungesë të reformave, rritja thjesht e burimeve të alokuara nuk e rrit barazinë ose nuk përmirëson cilësinë e arsimit.

Ndër shumë strategji që janë duke u zbatuar në vende të ndryshme të botës, e njohur është ajo e **Menaxhimit në Bazë Shkollë**. Thelbi i saj konsiston në decentralizimin e vendimmarrjes në arsim, nëpërmjet rritjes së përfshirjes së prindërve dhe të komunitetit në veprimtarinë e shkollave. Frytet e saj shihen në shumicën e atyre vendeve me rezultate të mira të nxënësve në testimet ndërkombëtare, autoritetet lokale dhe shkollat e të cilëve kanë marrë autonomi substanciale për vendimmarrje në përmbajtjen e kurrikulës së tyre, alokimin dhe menaxhimin e burimeve të tyre njerëzore, materiale e financiare, apo edhe në fuqizimin e motivimit profesional të drejtorëve dhe mësuesve të shkollave. E shndërruar në një lëvizje me përmasa globale, ajo ka përfshirë edhe zhvillimet e arsimit shqiptar.

Përcaktimi i Menaxhimit në Bazë Shkollë

Siç thamë, Menaxhim në Bazë Shkollë, do të thotë decentralizim i autoritetit nga qeveria qendrore tek niveli i shkollës. Konceptualisht, ai mund të shihet si një ndryshim formal i strukturave qeverisëse, i cili i identifikon shkollat individuale si njësitë primare të përmirësimit. Në këtë mënyrë, realizohet një rishpërndarje e autoritetit vendimmarrës, nga që ky autoritet konsiderohet si instrumenti i parë nëpërmjet të cilit mund të stimulohet dhe të mbështetet përmirësimi arsimor. Pra, në këtë proces decentralizues, përgjegjësia dhe autoriteti vendimmarrës mbi veprimet e shkollës transferohen tek drejtorët, mësuesit e prindërit, disa herë edhe tek nxënësit dhe anëtarët e komunitetit shkollor. Natyrisht, këta aktorë të nivelit shkollor duhet të konfirmohen dhe/ose të operojnë brenda politikave të përcaktuara nga qeveria qendrore. Format e ndryshme ekzistuese të “Menaxhimit në Bazë Shkollë” shpjegohen në varësi të faktit se **kush** e ka fuqinë për të marrë vendime dhe cila është **shkalla** e vendimmarrjes që është transferuar në nivelin e shkollës. Në disa raste, Menaxhimi në Bazë Shkollë, e transferon autoritetin vetëm tek drejtorët ose mësuesit, në rastet të tjera inkurajon, ose mandaton pjesëmarrjen prindërore

ose komunitare në veprimtarinë e shkollës. Në përgjithësi, “Menaxhimi në Bazë Shkollë” e transferon autoritetin tek një ose disa nga aktivitetet që pasojnë:

- Punësimi dhe pushimi i mësuesve dhe i stafit tjetër shkollor.
- Hartimi i kurrikulës.
- Prokurimi i teksteve shkollore dhe materialeve të tjera mësimore.
- Përmirësimi i infrastrukturës
- Rezultatet mësimore të nxënësve
- Alokimi i buxhetit

Arsimi i mirë nuk ka të bëjë vetëm me inputet fizike, të tilla si klasat, mësuesit dhe tekstet mësimore, por edhe me insentivat (stimujt) që të shpien tek një mësimdhënie/të nxëni sa më të mirë. Por, nisur nga nevojat e jashtëzakonshme për kapacitete menaxheriale, teknike dhe financiare të shtetit, si shërbim, arsimi është mjaft kompleks për të qenë efektiv nëse mbetet i organizuar në mënyrë qendrore. Rrjedhimisht, shumica e stimujve (insentivë) që afektojnë rezultatet e të nxënit kanë natyrë institucionale dhe mund të paraqiten në tre grupe:

- Zgjedhja dhe konkurrenca;
- Autonomia shkollore; dhe
- Përgjegjësia shkollore.

Ideja që qëndron prapa zgjedhjes dhe konkurrencës është se prindërit, të interesuar të maksimizojnë rezultatet e fëmijëve të tyre, janë të aftë të zgjedhin shkollat më të mira (në kuptimin e rezultateve akademike), ku të dërgojnë fëmijët e tyre. Ky presion i kërkesave të tyre mbi shkollat do ta përmirësonte performancën e të gjitha shkollave, nëse atyre do t'u duhej të konkurrojnë për të thithur nxënës. Në mënyrë të ngjashme, vendimmarrja lokale dhe decentralizimi fiskal mund të kenë efekte pozitive në rezultatet e shkollës, në testimet ose provimet e lirimt/maturës, duke i bërë shkollat të përgjegjshme për “rezultatet” që ato prodhojnë. Kjo ide mbështetet në paradigmen se “cilësi e mirë dhe shërbim i duhur mund të sigurohet nëse ofruesit janë përgjegjës para klientëve të tyre.” Në rastin e sektorit të arsimit, klientët janë nxënësit dhe prindërit e tyre.

Në vendet e zhvilluara, ideja themelore që qëndron prapa “Menaxhimit në Bazë Shkollë” është: *Kush punon në godinën shkollore duhet të ketë më shumë kontroll* në menaxhimin e asaj që ndodh në këtë godinë. Në vendet në zhvillim, kjo ide është më pak ambicioze dhe fokusohet më shumë në përfshirjen e komunitetit dhe të prindërve në procesin e vendimmarrjes shkollore se sa në vendosjen e tyre tërësisht nën kontroll. Sidoqoftë, në përgjithësi, në të dy rastet, roli i pushtetit qendror në arsim është i padiskutueshëm dhe përcaktimi i saktë i këtij roli afekton mënyrën e konceptimit dhe të zbatimit të veprimtarive të kësaj lëvizje.

Disa rezerva për “Menaxhimin në Bazë Shkollë”

Pavarësisht thelbit të Menaxhimit në Bazë Shkollë, askush nuk vë në dyshim ndërvarësinë midis qeverisë, administratës shkollore, sjelljes së mësuesit në klasë dhe, në shumë raste, qëndrimeve të prindërve. Pra, presupozohet se zbatimi në praktikë i Menaxhimit në Bazë Shkollë ofron garancinë që të gjithë këta aktorë të punojnë së bashku në një sistem besimi reciprok. Por, delegimi i fuqisë vendimmarrëse në nivelin e shkollës do të thotë që disa grupe jashtë shkollës, të tilla, si drejtori të MASH, DAR/ZA, ka të ngjarë të humbasin pjesë të pushtetit të tyre, duke ndryshuar kështu dinamikën e pushtetit brenda secilës shkollë. P.sh. kjo do të thotë që puna e mësuesve në klasë t'i nënshtrohet një kontrolli, i cili deri tani është kryer nga sektorët e inspektimit në nivel qendror dhe rajonal. Fakti që këtë detyrë tashmë e kryen IKAP-I do të thotë që drejtoritë përkatëse të MASH dhe DAR-et ta humbasin rolin inspektues mbi shkollat, pra, të pushtetit që shoqëron zotërimi i këtij roli. Rrjedhimisht, përcaktimi i Menaxhimit në Bazë Shkollë si transferim pushteti, në mënyrë të paevitueshme, e vështirëson

zbatimin e tij, sepse, ndërsa disa aktorë fitojnë, të tjerët humbasin. Gjë që është e vështirë të pranohet, nisur edhe nga fakti që kompetencat më të përhapura që tranferohen në nivelin e shkollës janë ato që shqetësojnë shumicën e shkollave: administrimi i tyre (personeli dhe buxheti), pedagogjia e tyre (kurrikula dhe praktikat mësimdhënëse) dhe marrëdhëniet e tyre të jashtme (me pushtetin dhe komunitetin lokal). Meqë stafit shkollor, prindërve dhe anëtarëve të komunitetit lokal i kalon më shumë vendimmarrje, janë pushtetarët qendrorë dhe lokalë ata që humbasin autoritetin (prandaj edhe kërkojnë ta rimarrin atë) që buron nga kompetencat për ndarjen e buxhetit, punësimin dhe pushimin e mësuesve nga puna. Është fjala për një mentalitet të ri, që duhet të zëvendësojë të vjetrin. Por, “më lehtë është të ndash bërthamën e atomit - thotë Ajshtajni - se sa të thyesh një mentalitet.”

Nga ana tjetër, shpesh, Menaxhimi në Bazë Shkolle kërkon që mësuesit të luajnë një rol më të madh në qeverisjen dhe menaxhimin e shkollave ku punojnë. Natyrisht, ky rol i ri e zgjeron qëllimin e punës së tyre. Por, nuk duhet harruar fakti që ky rol i ri kërkon që ata të konsumojnë më shumë kohë dhe energji, gjë që shpesh mund të kufizojë lirinë e tyre tradicionale për të kryer atë që duan brenda klasave të tyre. Jo të gjithë mësuesit e vlerësojnë marrjen përsipër të roleve dhe përgjegjësisë shtesë edhe kur këto ndryshime janë thelbësore. Prandaj, duke e shndërruar shkollën në qendrën e ndryshimit të politikës arsimore, Menaxhimi në Bazë Shkolle nuk e supozon neglizhimin e roleve që luajnë si pushteti qendror/lokal, ashtu edhe mësuesit e veçantë. Në përgjithësi, shkollat publike do të ekzistojnë në kontekste politike dhe administrative që afektojnë veprimet e tyre. Çelësi është të identifikohet saktësisht cili duhet të jetë roli i pushtetit qendror/lokal në vendimmarrje. Kjo është arsyeja përse në botë është rritur interesi për forcimin e supervizionit të shkollës. Këtij qëllimi i shërben edhe përpunimi i kompetencave të reja të DAR/ZA-ve në kontekstin e ndryshimeve të shpejta që janë duke ndodhur në arsimin shqiptar.

Por, cili është niveli i autonomisë shkollore në arsimin shqiptar?

Pa dyshim, duket se është herët të flasim për autonomi të fortë dhe shumë të fortë të shkollës shqiptare. Por, disa zhvillime që janë duke ndodhur krijojnë kushtet për të diskutuar për nivelin e kësaj autonomie. Le të fillojmë me decentralizimin e sistemit. Ka disa kompetenca që i kanë kaluar autoriteteve arsimore lokale dhe pushtetit vendor. Mirëmbajtja e shkollave, administrimi i konvikteve janë elemente të fortë decentralizues. Nëse zbresim në nivelin e shkollës, nuk mund të themi se shkollat nuk kanë autonomi. Mund të pranojmë se ato kanë një autonomi të kufizuar, që tenton të jetë e moderuar. Kështu, mësuesi ka fituar të drejtën që të vendosë ta zhvillojë një kapitull ose linjë lëndore në një lëndë deri në 10% më shumë, ose deri në 10% më pak orë mësimore, kundrejt numrit të orëve të parashikuara në programin përkatës lëndor. Ndërkaq, pjesën e quajtur “orë të lira”, e cila zë 10% -15% të orëve totale, mësuesi mund ta përdor për përfundimin e lëndëve të planit mësimor, provimet e lirim, Maturës Shtetërore, projekte kurrikulare, module mësimore, lëndë me zgjedhje, veprimtari të ndryshme shkollore dhe vlerësime në nivel shkolle të arritjeve të nxënësve. Shumë shpejt, shkollat e mesme fituan kompetencën për të ofruar lëndë me zgjedhje për nxënësit e tyre, si edhe për të bërë ekuivalentimin e nxënësve që kalojnë nga një kategori shkolle në tjetrën. Nga ana tjetër, Alterteksti, ende larg një akti që garanton autonomi shkollore në zgjedhjen e kurrikulës, u ka dhënë shkollave kompetencën për të zgjedhur tekstet mësimore në mozaikun që ofron MASH. Po kështu, shkolla ka fituar kompetencën për grumbullimin, ruajtjen dhe përdorimin e të ardhurave nga dhurimet nga prindërit e nxënësve të shkollave të arsimit parauniversitar, e drejtë e cila menaxhohet dhe monitorohet nga bordi i shkollës. Qeveria e nxënësve, këshilli i prindërve, këshilli i disiplinës janë aktorë të nivelit institucional, të cilët shtrojnë shinat e një autonomie të pritshme më të lartë shkollore. Gjë që duket në lëvizjet e ndërmarra për licencimin e mësuesve, certifikimin e drejtuesve të shkollave, të drejtat e drejtuesve të shkollave për të zgjedhur stafin mësimor, një politikë të re në fushën e trajnimit dhe kualifikimit të mësuesve etj. Pra, nëse nuk mund të përcaktojmë shkallën e autonomisë së shkollës shqiptare në kontekstin e mësipërm, mund të deklarojmë me bindje se në jetën e saj ka shumë elemente që të ofrojnë shijen e autonomisë disi të fortë.

Këto zhvillime kanë identifikuar anën tjetër të problemit, e cila ka të bëjë me atë se kush merr fuqi vendimmarrëse, kur ajo kalon në nivelin e shkollës. Kjo është një detyrë e vështirë dhe sistemit tonë arsimor i duhet të zgjedh në menynë ekzistuese të katër modeleve të fuqisë vendimmarrëse: 1) kontrolli administrativ; 2) kontrolli profesional; 3) kontrolli komunitar; dhe 4) kontrolli i balancuar. Kontrolli Administrativ i MBS (modeli holandez) e kalon autoritetin tek drejtori i shkollës. Ky model synon ta bëjë shkollën më përgjegjëse ndaj organeve lokale arsimore nëpërmjet rritjes së eficiencës së shpenzimeve për personelin dhe kurrikulën, si dhe rritjes së përgjegjësisë së secilit person në shkollë ndaj organeve lokale arsimore. Kontrolli Profesional i MBS (modeli finlandez) e kalon autoritetin vendimmarrës tek mësuesit, duke synuar përdorimin sa më të mirë të njohurive të mësuesve për nevojat e shkollës në nivel klase. Po kështu, pjesëmarrja e plotë e mësuesve në vendimmarrje mund t'i motivojë ata të punojnë më mirë, gjë që shoqërohet me rritje të efektivitetit dhe eficiencës në mësimdhënie. Kontrolli Komunitar i MBS (Meksikë, Zelandë e Re, Salvador etj.) e kalon vendimmarrjen tek prindërit ose komuniteti. Në këtë model, supozohet që mësuesit dhe drejtuesit të bëhen më të përgjegjshëm ndaj nevojave të prindërve dhe se kurrikula mund/duhet të reflektojë nevojat dhe preferencat lokale. Kontrolli i Balancuar i MBS (Miçigan, disa shtete të Meksikës etj.) e balancon vendimmarrjen midis prindërve dhe mësuesve, të cilët janë dy aktorët kryesorë të çdo shkolle. Modeli synon përdorimin e njohurive të mësuesve për përmirësimin e menaxhimit të shkollës, për ta bërë atë më të përgjegjshme para prindërve. Në përgjithësi, në botë, modelet ekzistuese të menaxhimit në bazë shkolle janë një përzierje e katër modeleve të mësipërme. Në shumicën e rasteve, fuqia i është dhënë një aktori legal formal në formën e këshillit të shkollës, ose të komitetit të menaxhimit të shkollës, të cilët përbëhen nga mësuesit dhe nga drejtori. Thuajse në të gjithë versionet e MBS, përfaqësuesit e komunitetit marrin pjesë në këto organizma.

Konkluzion

“Menaxhimi në Bazë Shkolle”, i shndërruar në një lëvizje globale, ka përfshirë edhe sistemin tonë arsimor. Duke e konsideruar shkollën si njësinë bazë, ku duhet të ndodhin përmirësimet e cilësisë së formimit të nxënësve tanë, ai decentralizon autoritetin vendimmarrës për problem themelore, të cilët janë jetike për shkollën. Në dualizmin midis përqendrimit të autoritetit vendimmarrës dhe decentralizimit të tij, e ardhmja është për decentralizimin. Kjo është edhe një nga arsyet e fuqizimit të supervizionit të jashtëm të shkollave. Shoqëria kërkon garanci nëse shkollat janë duke e ushtruar autonominë e fituar në dobi të cilësisë në rritje të edukimit të fëmijëve të tyre. Rolin e garantit e luan inspektimi i jashtëm.

Referenca

1. Anderson, J. A. (2005). Accountability in Education. Education Policy Series. The International Institute for Educational Planning and The International Academy of Education, Paris and Brussels.
2. Bardhan, P., and D. Mookherjee (2000). “Capture and Governance at the Local and National Levels.” American Economic Review 90(2): 135-139.
3. Caldwell, B. J. (2005). School-based Management. Education Policy Series. The International Institute for Educational Planning and The International Academy of Education, Paris and Brussels.
4. Carnoy, M., A. Gove, S. Loeb, J. Marshall, and M. Socias (2004). “How Schools and Students Respond to School Improvement Programs: 5. Cook, T. D. (2007). “School-based Management in the United States.” Background paper prepared for the programmatic study on school-based management for the World Bank, Washington, DC.
6. Cook, T. D., H. D. Hunt, and R. F. Murphy (2000). “Comer’s School Development Program in Chicago: A Theory-of-based - management.
7. Udhëzim i MASH nr. 35, date 09.10.2007 “Për lirinë e mësuesit për orët mësimore të parashikuara në programin lëndor”.
8. Udhëzim i MASH nr. 35, date 09.10.2007 “Për lirinë zhvillimin e orëve të lira në shkolle”.
9. IKT 92008) “Standardet e nxënësve për gjimnazin”.

U D H Ë Z I M

PËR MBARËVAJTJEN E PUNËS MËSIMORE-EDUKATIVE NË SISTEMIN E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË VITIN SHKOLLOR 2010- 2011

KREU I

PROGRAMET DHE TEKSTET MËSIMORE NË ARSIMIN PARASHKOLLOR DHE NË ARSIMIN BAZË

1. Arsimi parashkollor

Veprimtaria edukative-mësimore të zhvillohet në zbatim të:

- Programit të arsimit parashkollor për grupmoshat 3-4, 4-5 dhe 5-6-vjeçare;
- Standardeve të përmbajtjes në arsimin parashkollor;
- Standardeve të arritjes në arsimin parashkollor.

Veprimtaria mësimore-edukative në klasat përgatitore, që do të hapen në kuadër të zbatimit të projektit “Cilësi e barazi në arsim”, të zhvillohet në zbatim të shkresës nr. 4445, datë 30.06.2009 të Drejtorisë së Edukimit Parauniversitar të MASH-it.

2. Arsimi bazë

Në klasat I-IX të arsimit bazë:

- të punohet me strukturën dhe planet mësimore sipas Udhëzimit Nr. 17, datë 29.06.2010 “Për strukturën dhe planet mësimore në arsimin parauniversitar për vitin shkollor 2010-2011”;
- të zbatohen programet me të cilat është punuar vitin e kaluar shkollor në të gjitha lëndët, me përjashtim të programeve të reja të lëndëve “Gjuhë shqipe 9” dhe “Informatikë 9”.

Tekstet alternative të përzgjidhen vetëm nga katalogu “Altertekst-2010” të dërguar nga MASH-i.

3. Arsimi bazë i pakicave kombëtare dhe i nxënësve me aftësi të kufizuar

- Në klasat I-IX të arsimit bazë të pakicave kombëtare të punohet me programe mësimore të sistemit të ri arsimor 9-vjeçar, të cilat realizohen sipas udhëzimit ekzistues.
- Në shkollat e pakicave kombëtare greke dhe maqedonase të zhvillohet provimi i lirimit edhe për gjuhën amtare. Tezat për këtë provim të përgatiten nga DAR Gjirokastër dhe Korçë.
- Për Institutin e nxënësve që nuk shikojnë, testet e provimeve të lirimit të tërhiqen në AVA nga drejtoria e institutit, një ditë para zhvillimit të provimit, për t’i kthyer ato në BRAIL.

KREU II

PROGRAMET DHE TEKSTET MËSIMORE NË ARSIMIN E MESËM

Baza ligjore

Në arsimin e mesëm, veprimtaritë mësimore-edukative, kriteret e emërimit të personelit mësimor dhe drejtues, ngarkesat mësimore javore dhe vjetore, vlerësimi i nxënësit në gjimnaz, kriteret e ekuivalentimit të studimeve, hapjen e degëve të reja të arsimit profesional, si dhe përzgjedhja e teksteve alternative të mbështeten në:

- Udhëzimin Nr. 17, datë 29.06.2010 “Për strukturën dhe planet mësimore në arsimin parauniversitar për vitin shkollor 2010 - 2011”;
- Udhëzimin Nr. 21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”;
- Rregulloren Nr. 2264/1, datë 05.04.2010 “Për zhvillimin e olimpiadave të lëndëve shkencore në arsimin parauniversitar”;
- Udhëzimin Nr 22, datë 29.07.2010 “Për emërimet e personelit mësimor dhe drejtues në arsimin parauniversitar”;
- Udhëzimin Nr 23, datë 30.07.2010 “Për njëvlershmërinë e studimeve në shkollat e mesme me kohë të plotë dhe me kohë të shkurtuar, në sistemin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”;
- Urdhrin Nr. 326, datë 22.06.2010 “Për hapjen e drejtimin mësimor Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, në disa shkolla të mesme profesionale”;
- Rregulloren Nr 4998, datë 27.07.2010 për vlerësimin e nxënësit në gjimnaz.

Dizpozitë tranzitore për nxënësit mbetës në klasën e 11-të (2009-2010)

Nxënësi që është mbetës në klasën e 11-të, të mbartë në klasën e 11-të të vitit shkollor 2010-2011, lëndë të kurrikulës bërthamë dhe me zgjedhje së bashku me kreditet përkatëse.

a. Kurrikula bërthamë

Në tabelën më poshtë janë lëndët që nxënësi ka zhvilluar në klasën e 10-të dhe që do të vlerësohen si lëndë të kurrikulës bërthamë (me kreditet për çdo lëndë):

Nr	Lënda	Kreditet
1	Biologjia	2
2	Edukimi fizik	2
3	Gjeografia	2
4	Gjuha e huaj e parë	3
5	Gjuha shqipe e letërsia	3
6	Historia	2
7	Kimia	2
8	Matematika	3
9	Njohuri për shoqërinë	2
10	Teknologjia	1
11	TIK	2
	Gjithsej	24

Shënime.

- Lënda “Gjeografi 10” është e njëvlershme me lëndën “Shkenca e Tokës” në kurrikulën e re.
 - Lënda “Njohuri për shoqërinë 10” është e njëvlershme me lëndën “Qytetaria” në kurrikulën e re.
 - Nxënësi i ka zhvilluar lëndët “Gjuha shqipe e letërsia 10” dhe “Matematika 10” me nga 4 orë në javë, por i njihen me nga 3 kredite secila.
 - Në mënyrë që nxënësi të plotësojë lëndët e kurrikulës bërthamë të klasës së 10-të me 26 orë, duhet të japë në provim jo më vonë se fundi i muajit tetor 2010:
 - 36 orë të një lënde nga fusha e arteve;
 - 36 orë të një lënde nga fusha e aftësisimit për jetën dhe karrierën.
- Nxënësi duhet të përzgjedhë ndërmjet pesë lëndëve të fushës së arteve dhe tri lëndëve të aftësisimit për jetën. Kur nxënësi mbetet në njërin ose të dyja këto lëndë, i jep ato në provimin e vjeshtës 2011.

b. Kurrikula me zgjedhje

- Kur nxënësi ka pasur lëndë me zgjedhje në klasën e 10-të, atij i njihet kjo lëndë në kurrikulën me zgjedhje të detyruar me 2 kredite.
- Nëse nxënësi nuk ka pasur lëndë me zgjedhje në klasën e 10-të, lënda “Edukimi fizik” e klasës së 11-të i njihet si lëndë në kurrikulën me zgjedhje të detyruar me 2 kredite.
- Nxënësi i njihen dy përforcime ndër lëndët e klasës së 11-të, ku është kalues, duke siguruar 2 kredite për kurrikulën me zgjedhje të lirë.
- Nxënësi vazhdon klasën e 11-të dhe të 12-të njëlloj si nxënësit e tjerë për kurrikulën bërthamë dhe atë me zgjedhje.

Programe dhe tekste

Gjimnazi me kohë të plotë:

Për arsimin e mesëm të përgjithshëm (gjimnazet), në klasën e 10-të të punohet me programet e vitit të kaluar shkollor.

Në klasën e 11-të, të gjitha programet e lëndëve bërthamë ose me zgjedhje, si dhe tekstet përkatëse, janë të reja.

Në klasën e 12-të të zbatohet struktura e vjetër e gjimnazit me po ato programe dhe tekste, me përjashtim të lëndës së Historisë së Shqipërisë (profili natyror dhe profili shoqëror).

- Çdo shkollë të pajiset me programet e lëndëve me zgjedhje të detyruar dhe të lëndëve me zgjedhje të lirë, me përjashtim të programeve të përforcimeve, që hartohen nga vetë mësuesi.
- Tekstet shkollore për klasën e 10-të, të 11-të dhe të 12-të janë bërë publike dhe janë shpallur në katalogun e teksteve 2010. DAR/ZA-të dhe drejtuesit e shkollave të mesme të përgjithshme të kërkojnë zbatimin me rigorozitet të kurrikulës së re në klasën e 11-të, pa hequr vëmendjen nga kurrikula e klasës së 10-të.
- Shkollat në qytete të kërkojnë mundësitë për ta zbatuar lëndën “Artet” kryesisht në rrafshin praktik, për të shmangur trajtimet teorike, që u vunë re vitin e kaluar shkollor.
- Të bëhet punë sqaruese me prindërit dhe nxënësit për lëndët me zgjedhje të detyruar dhe të lirë. Situata që krijohet pas zgjedhjes së tyre, të menaxhohet mirë nga drejtuesit e shkollave sidomos në rrafshin teknik, duke hartuar orare të përshtatshme për nxënësit. Drejtuesit të jenë të kujdesshëm në ndarjen lëndore, duke parë gjithmonë interesat e nxënësve dhe forcimin e punës mësimore-educative të shkollës.

Gjimnazi me kohë të shkurtuar:

- Klasat 12 dhe 13 të gjimnazit me kohë të shkurtuar të punojnë me planin mësimor ekzistues.
- Klasat 10 dhe 11 të punojnë me programet e reja, të miratuara më 2009 dhe 2010. Në klasën e 10-të të përdoren tekstet e gjimnazit me kohë të plotë.

Shkollat e gjuhëve të huaja

- Klasat 10 dhe 11 të punojnë me programet e reja, të miratuara më 2009 dhe 2010.
- Klasat e 12-ta të punojnë me planet dhe programet mësimore ekzistuese.
- Tekstet e gjuhëve të huaja për shkollat e mesme të gjuhëve të huaja të përzgjidhen nga vetë shkollat sipas praktikës të ndjekur deri tani.

Seksionet dygjuhëshe

- Në seksionet dygjuhëshe italiane, frënge dhe gjermane, për lëndët “gjuhë e huaj”, që zhvillohen në gjuhën e huaj, të zbatohen planet mësimore bashkëngjitur memorandumeve dhe konventës.
- Programet mësimore të hartuara për këto shkolla dhe tekstet e zgjedhura për këto seksione, të zbatohen në përputhje me planet mësimore bashkëngjitur memorandumeve përkatëse dhe konventës.

Këshillimi për karrierën

Në kuadrin e konsolidimit të procesit të Maturës Shtetërore dhe mirinformimit të nxënësve, mësuesve dhe prindërve për Maturën Shtetërore dhe për sistemin Meritë-Preferencë, DAR/ZA-të dhe drejtoritë e shkollave të mesme të marrin masat për planifikimin gjithëvjeter të punës për këshillimin për karrierën. Zëvendës drejtorët/mësuesit e ngarkuar për këshillimin për karrierën të hartojnë plane pune vjetore, të miratuara nga drejtoritë e shkollave dhe DAR/ZA-të. Drejtoria e Edukimit Parauniversitar të monitorojë gjatë gjithë vitit shkollor punën e kryer për këtë proces.

Analizat e rezultateve të Maturës Shtetërore 2010 dhe të Provimeve të Lirimit

DAR/ZA-të të analizojnë me shumë përgjegjësi rezultatet dhe mënyrën e administrimit të provimeve të Maturës Shtetërore 2010.

a. Analiza e rezultateve të Maturës Shtetërore 2010 të zhvillohet nga të gjitha DAR/ZA-të, me synimin që:

- të evidencohen shkollat me arritjet më të mira si dhe nxënësit më të mirë të Maturës Shtetërore 2010 në nivel DAR/ZA-je;
- të përgatitet një studim ku t’i kushtohet vëmendje e veçantë diferencës midis notës vjetore dhe rezultateve të Maturës Shtetërore 2010;
- të merren në shqyrtim procesi i administrimit të provimeve, ai i trajnimit të administratorëve si dhe rezultatet e dala nga KO-

POTED-et;

- DAR/ZA-të të përgatisin kalendarin e analizës së Maturës Shtetërore 2010 (5-26 nëntor 2010). Studimi i rezultateve të Maturës Shtetërore 2010 të dërgohet paraprakisht në Drejtorinë e Edukimit Parauniversitar në MASH;
- të zbatohen masat e marra për drejtorët e shkollave, administratorët dhe mësuesit në përputhje me Rregulloren e Maturës Shtetërore.
- Drejtoria e Edukimit Parauniversitar të ndjekë analizën e Maturës Shtetërore 2010 në të gjitha DAR/ZA-të.

b. Analiza e rezultateve të Provimeve të Lirimit 2010 të zhvillohet me synim:

- evidencimin e korrektesës në procesin e administrimit;
- evidencimin e diferencave midis notës vjetore dhe notës së Provimeve të Lirimit;
- zbatimin e masave të marra për drejtorët e shkollave, administratorët dhe mësuesit në përputhje me Rregulloren e Provimeve të Lirimit.

KREU III

STRATEGJI, POLITIKA, PROGRAME DHE PROJEKTE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

Shërbimi psikologjik shkollor

DAR/ZA-të të marrin të gjitha masat që:

- në fillim të vitit të ri shkollor të kenë zëvendësuar të gjithë psikologët që nuk kanë arsim përkatës, sipas Udhëzimit Nr. 18, datë 21.04.2008 “Për funksionimin e shërbimit psikologjik shkollor në sistemin arsimor parauniversitar”;
- të sigurojnë kabinetin e shërbimit psikologjik dhe pajisjen e tij në të gjitha shkollat që ofrojnë këtë shërbim;
- të ngrihet, në çdo shkollë ku funksionon shërbimi, grupi i mbështetjes së psikologut;
- të planifikohet dhe të realizohet raporti i veprimtarisë gjithëvjetore të shërbimit psikologjik në shkollë.

Zbatimi i Aksionit Kombëtar për reduktimin në zero të braktisjes shkollore

Realizimi i këtij aksioni mbështetet nga “Plani i veprimit për reduktimin në zero të braktisjes shkollore 2009-2013”. Për uljen e treguesve të braktisjes shkollore, DAR/ZA-të të marrin këto masa:

- të ngarkohet një specialist që do të merret me hartimin dhe monitorimin e zbatimit të planit të veprimtarive vjetore në nivel DAR/ZA-je për këtë problem;
- të raportohet në MASH dy herë në vit, për realizimin e këtij plani. Raportimi të shoqërohet me informacionin statistikor të braktisjes shkollore për klasat I-IX;
- të trajnohen mësuesit që punojnë me nxënës që kanë braktisur shkollën, ose që shfaqin prirje për braktisjen e saj;
- të hartohen programe të veçanta pune në nivel klase dhe shkollë për ndërgjegjësimin e prindërve për rëndësinë e shkollimit;
- të vazhdojë arsimimi i nxënësve të ngjuar sipas Udhëzimit të MASH-it Nr. 9, datë 11.04.2007 “Për arsimimin e nxënësve të ngjuar për shkak të gjakmarrjes”;
- të vazhdojë zbatimi i Udhëzimit të MASH-it Nr. 34, datë 08.12.2004 “Për zbatimin e projektit “Shansi i dytë” për arsimimin e nxënësve që kanë braktisur shkollën dhe nxënësve të ngjuar për shkak të gjakmarrjes”.

Zbatimi i strategjive ndërministrrore

MASH është pjesë e hartimit dhe zbatimit të strategjive kombëtare ndërministrrore të Qeverisë Shqiptare, si:

- Strategjia Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom si dhe Plani i Veprimit të Dekadës Rome;
- Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar;
- Strategjia “Për riintegrimin e emigrantëve shqiptarë të kthyer 2010-2015”.

DAR/ZA-ve u del si detyrë që:

- të caktojnë një person përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të këtyre strategjive;
- të hartojnë plane pune vjetore me detyra të konkrete, të cilat prekin këto strategji;
- të monitorojnë zbatimin e detyrimeve që lindin nga këto strategji në nivel shkollë;
- të raportojnë në mënyrë periodike në MASH për veprimtaritë dhe për të dhëna statistikore për çdo strategji.

Për realizimin e detyrimeve që lindin nga këto strategji, MASH-i, DAR/ZA-të dhe shkollat, të bashkëpunojnë edhe me OJQ-të e specializuara dhe të interesuara në këto fusha. Bashkëpunimi të mbështetet në marrëveshje, memorandume dhe projekteve dy- ose shumëpalëshe, të nënshkruara ose miratuara domosdoshmërisht nga MASH-i.

KREU IV

VEPRIMTARI EDUKATIVE

a. Përzgjedhja e literaturës së rekomanduar në fushën e letërsisë, historisë, filozofisë, sociologjisë psikologjisë dhe e literaturës shkencore e didaktike të kryhet sipas kësaj procedure:

- DAR/ZA-të të përzgjedhin për bibliotekat e shkollave literaturë në fushën e letërsisë, historisë, filozofisë, sociologjisë, psikologjisë dhe shkencave natyrore në ndihmë të procesit mësimor-edukativ, nga lista rekomanduese e MASH-it, e cila dërgohet në DAR/ZA brenda muajit shtator 2010.
- Në mbështetje të Urdhrit të MASH-it Nr. 278, datë 20.05.2010, pikat 6 dhe 7, DAR/ZA-të t'i dërgojnë kopjen zyrtare të literaturës së rekomanduar çdo shkollë të arsimit parauniversitar nën juridiksionin e tyre.

b. Veprimtaritë edukative

Drejtoritë e shkollave të forcojnë nivelin e punës edukative duke hartuar planin edukativ të shkollës dhe atë të klasave në bashkërendim me organet demokratike të shkollës.

Shkolla të jetë qendra e veprimtarive artistike dhe sportive të nxënësve. Të zbatohet udhëzimi për normat mësimore kur plotësohen kushtet e nevojshme për ngritjen e ekipeve sportive në nivel shkollë. Drejtoritë e shkollave të hartojnë plane pune dhe të ndjekin me

rigorozitet veprimtaritë e këtyre ekipeve deri në ditën e fundit të shkollës.

Të fuqizohet puna me librin në shkollë duke vënë më mirë në funksion bibliotekën e shkollës, si dhe veprimtarinë e klubeve letrare të shkollës. Të nxitet veprimtaria krijuese letrare e nxënësve, duke vënë në krye të punës me librin mësuesin më të përkushtuar të lëndës së letërsisë. Në qendër të veprimtarive edukative që zhvillon shkolla, të jenë promovimi dhe nxitja e talenteve letrare.

Të rritet roli i mësuesit kujdestar për problemet edukative në shkollë.

Në qendër të vëmendjes, gjatë planifikimit të punës edukative të shkollës dhe të klasave, të jenë:

- Përkujtimi i festave kombëtare dhe të ditëve të traditës.

Në këtë vit shkollor kremtohet 100-vjetori i lindjes së Nënë Terezës. Shkollat të zbërthejnë figurën e saj shumëplanëshe për ta paraqitur te nxënësit si një model i përsosur edukativ edhe nëpërmjet programimit të veprimtarive të shumta.

- Tema të ndryshme që lidhen me integrimin evropian të vendit tonë.
- Veprimtari ndërgjegjësuese për Ditën e Romëve, ditën e aftësisë së kufizuar dhe autizmit, ditën e barazisë gjinore, ditën e luftës kundër dhunës, duhanit, alkoolit, SIDA-s etj.
- Ekskursionet për njohjen e historisë, gjeografisë dhe natyrës së vendit.

Ato të zhvillohen në mbështetje të Urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 174, datë 23.05.2007 “Për miratimin e lejes për zhvillimin e veprimtarive jashtëshkollore në institucionet arsimore publike e jopublike”. Në këtë kuadër, të realizohen vizita e binjakëzime me shkollat shqipfolëse në rajon.

- Konkursat, olimpiadat, veprimtaritë artistike dhe sportive në nivel lokal e qendror.
- Organizimi dhe menaxhimi i fazave përgatitore dhe fazës finale të olimpiadave kombëtare në lëndët Matematikë, Fizikë, Kimi, Biologji dhe Informatikë.

Të gjitha olimpiadat të realizohen në mbështetje të Rregullores Nr. 2264/1, datë 05.04.2010 “Për zhvillimin e olimpiadave të lëndëve shkencore në arsimin parauniversitar”.

- Veprimtaritë edukative në fushën e gjuhëve të huaja në kuadrin e Ditës Evropiane të Gjuhëve.

c. Veprimtari në bashkëpunim edhe me ministri të tjera

DAR/ZA-të dhe drejtoritë e shkollave të tregojnë kujdes për zbatimin e detyrave dhe angazhimeve që burojnë nga Marrëveshja Nr. 7965 prot., datë 17.11.2008, ndërmjet MTKRS-së dhe MASH-it, duke mbështetur bashkëpunimin ndërmjet shoqatave sportive vendore, federatave sportive dhe shkollave.

KREU V

ZBATIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË ARSIM PARAUNIVERSITAR

Të kryhet trajnimi në vazhdimësi i mësuesve të lëndëve të tjera për gërshetimin e TIK edhe në kurrikulat e tjera gjatë procesit të mësimdhënies. Zhvillimi dhe përdorimi përherë e në rritje i teknologjive të informacionit në arsim të mundësojnë rritjen e cilësisë së menaxhimit arsimor.

Prioritet kryesor për prezantimin dhe integrimin e vazhdueshëm të TIK në arsim të jenë:

- Zhvillimi i harmonizuar i EMIS;
- Përmirësimi dhe shtimi i sasisë dhe cilësisë së sistemeve dhe pajisjeve elektronike në ndihmë të arsimit (kompjuterë, printerë, skanerë, lap-top, videoprojektorë, internet dhe përmbajtje multimediale për mësimdhënien);
- Konceptimi dhe zhvillimi i Librarisë Dixhitale etj.

Për të garantuar sukses të vazhdueshëm të realizimit të objektivave që lidhen me TIK-un në arsim, nevojitet që mësuesit e sistemit parauniversitar të cilët do të japin lëndën e informatikës:

- Të kenë kryer apo të kryejnë me sukses trajnimin e ofruar nga MASH-i, me synim aftësimin e tyre për mësimdhënien e lëndës së informatikës.
- Të kujdesen për mirëmbajtjen e laboratorëve të informatikës dhe të përdorimit të aksesit në internet vetëm për qëllime mësimore.
- Të nxisin përfshirjen e teknologjisë së informacionit në lëndët e tjera, duke asistuar kolegët e këtyre lëndëve në përdorimin e lap-topëve dhe videoprojektorëve për mësimdhënie.

KREU VI

ARSIMI PROFESIONAL E TEKNIK

Në kuadër të reformimit të Arsimit Profesional e Teknik, në vitin shkollor 2010-2011, klasat e para dhe të dyta të shkollave profesionale të punojnë me skeletkurrikulat e nivelit të parë (2-vjeçar).

Lëndët e kulturës së përgjithshme janë të përbashkëta për të njëjtën strukturë në të gjitha drejtimet mësimore të shkollave profesionale e teknike.

Programet mësimore të lëndëve të kulturës së përgjithshme dhe të lëndëve profesionale në sistemin e APT:

- Programet mësimore të lëndëve të kulturës së përgjithshme për shkollat e Arsimit Profesional dhe Teknik, sipas planeve mësimore të miratuara nga MASH, bazohen në programet e gjimnazit, duke bërë ndryshimet dhe përshtatjet përkatëse. Këto programe janë në një botim të veçantë të IZhA-s (publikuar në vitin shkollor 2009-2010), i cili do t'u shërbejë drejtuesve dhe mësuesve për organizimin dhe drejtimin e punës në shkollat përkatëse.
- Pjesët përbërëse të skeletkurrikulave për çdo drejtim mësimor janë:
 - Lëndët e kulturës profesionale,
 - Modulet e praktikave profesionale të detyruara,
 - Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar.
- Për profilin Instalues Hidrosanitar, shkollat të punojnë me skeletkurrikulën përkatëse të përgatitur me mbështetjen e specialistëve të Programit Zvicëran AlbVet, në bazë të të cilit drejtoritë e shkollave, së bashku me departamentet e lëndëve profesionale, të përgatisin kurrikulin shkollor të klasës së dytë.

Shkollat ku do të hapet dega e re e TIK për vitin shkollor 2010-2011, do të jenë:

- Në DAR-të Dibër: “Nazmi Rushiti”; Elbasan: “Sali Ceka”; Berat: “Stiliano Bandilli”; Fier: “Petro Sota”; Kukës: “Havzi Nela”; Lezhë: “Kolin Gjoka”; Gjirokastrë: “Thoma Papano”; Tiranë-Qark: “Bujqësore Kamëz”;

- Në ZA-të Kavajë: “26 Marsi”; Lushnjë: “Mekanike Bujqësore”; Sarandë: “Antoni Athanas”; Pogradec: “Enver Qeraxhi”.

DAR/ZA-të dhe shkollat përkatëse të marrin masat e mëposhtme:

- Sigurimi dhe përshtatja e mjediseve për klasa mësimore dhe laboratorët.
- Përzgjedhja e specialistëve (mësues dhe instruktorë) që do të zhvillojnë lëndët teknike.
- Planifikimi gjithëvjetor i trajnimit të mësuesve dhe instruktorëve që do të zhvillojnë lëndët dhe praktikat profesionale në këtë degë.
- Përzgjedhja e nxënësve që do të regjistrohen në këtë degë, për të krijuar klasa me jo më pak se 25 nxënës sa më cilësorë.

KREU VII

ARSIMI PARAUNIVERSITAR PRIVAT

Gjatë vitit shkollor 2010-2011, të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar privat në Republikën e Shqipërisë të funksionojnë në mbështetje të legjislacionit të miratuar për arsimin parauniversitar në Shqipëri dhe të urdhrave e udhëzimeve të MASH-it për këto institucione.

Të gjitha institucionet arsimore private të garantojnë shërbim cilësor arsimor ndaj publikut dhe të përmbushin të gjitha detyrimet që rrjedhin nga e drejta për arsimim e shtetasve shqiptarë dhe nga marrëveshjet kontraktuale me nxënësit dhe me personelin mësimdhënës e jomësimdhënës. Ato të përshtatin planet dhe programet mësimore me ndryshimet që ndodhin në sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

DAR/ZA-të t’u kushtojnë vëmendje të veçantë ecurisë së procesit mësimor-edukativ, trajnimit të mësuesve, plotësimit me dokumentacionin përkatës shkollor dhe inspektimit periodik në këto institucione. IZHA të ofrojë trajnime periodike për mësuesit e shkollave private në mbështetje të planit trajnues e kualifikues të hartuar nga ajo dhe nga DAR/ZA-të, si dhe të kërkesave të vetë shkollave private.

KREU VIII

ROLI DHE DETYRAT E STRUKTURAVE INSPEKTUESE

Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar (IKAP) sipas një plani aktiviteteve të miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, gjatë vitit mësimor 2010-2011, në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha DAR/ZA-të, të ushtrojë funksionet e inspektimit, monitorimit, vlerësimit dhe këshillimit për:

- Zhvillimin e kurrikulës së zbatuar në të tri nivelet e arsimit parauniversitar, përkatësisht në arsimin parashkollor, arsimin bazë, arsimi i mesëm (gjimnazet dhe shkollat profesionale) në të gjitha DAR/ZA-të e vendit.
- Zbatimin e ligshmërisë nga institucionet e arsimit parauniversitar (DAR/ZA-të, shkollat publike dhe private), përkatësisht për: Ligjin për Sistemin Arsimor Parauniversitar, Dispozitat Normative të Arsimit Parauniversitar, udhëzimet, urdhrat dhe udhëzuesit e ndryshëm të MASH-it. Në mënyrë të veçantë të inspektohet zbatimi i udhëzimeve zyrtare që lidhen me ngarkesën dhe normën e mësuesve dhe të drejtuesve të shkollës.
- Monitorimin e procedurave të shpërndarjes dhe pajisjes së nxënësve me tekste shkollore, si dhe procesin e pajisjes së bibliotekave shkollore me literaturë artistike, shkencore dhe didaktike.
- Monitorimin e funksionimit të DAR/ZA-ve sipas strukturave dhe përshkrimeve të reja të punës.
- Vlerësimin e brendshëm të shkollave, përmes krijimit të rrjetit të shkollave-pilot në çdo DAR/ZA, të cilat do të specializohen në përgatitjen e raportit vjetor të vlerësimit të brendshëm të shkollës, duke përdorur instrumente standarde të vetëvlerësimit sipas përvojave më të avancuara perëndimore.
- Monitorimin e procesit mësimor dhe edukativ në institucionet e arsimit privat.

KREU IX

TRAJNIMI DHE KUALIFIKIMI

Gjatë muajit shtator 2010, DAR/ZA-të të menaxhojnë trajnimin e mësuesve të klasës së njëmbëdhjetë në lidhje me zbatimin e kurrikulës së re.

DAR/ZA-të dhe shkollat të zhvillojnë veprimtaritë trajnuese, duke u mbështetur në programet njëvjeçare të zhvillimit profesional të mësuesve. Ato të planifikojnë kualifikimin e mësuesve, të cilët mbushin 5, 10 dhe 20 vite pune në arsim deri në fund të dhjetorit 2010. IZHA, në bashkëpunim me DAR/ZA-të dhe shkollat, të monitorojë trajnimet në nivel qendror, lokal dhe në nivel shkolle, sidomos trajnimet që lidhen me ndryshimet kurrikulare.

Për organizimin e veprimtarive kualifikuese, DAR/ZA-të dhe shkollat të shfrytëzojnë edhe periudhat e ndërmjetme të pushimeve (tetor dhe prill), sipas një grafiku të hartuar në muajin shtator.

KREU X

REGJISTRIMET DHE PAJISJA E NXËNËSVE ME TEKSTE SHKOLLORE

1. Regjistrimet e nxënësve në shkollat e arsimit parauniversitar fillojnë ëë datën 23.08.2010 dhe mbyllen në datën 05 shtator 2010.
2. DAR/ZA-të, në bashkëpunim me pushtetin vendor, të sigurojnë regjistrimin e nxënësve në përshtatje me vendbanimin e tyre.
3. Regjistrimi i nxënësve që kanë ardhur nga zona të tjera, të bëhet me fletëshpërngulje dhe fletëpranimi, të cilat do të evidentohen me rigorozitet në balancimin e kontigjentit të nxënësve.
4. DAR/ZA-të, sipas afateve të përcaktuara në formularin operativ “Lëvizja dhe balancimi i kontingjenteve të nxënësve” dhe detyrimeve për reduktimin në zero të braktisjes shkollore, të dërgojnë në MASH të dhënat mbi lëvizjet e nxënësve të arsimit bazë.
5. DAR/ZA të marrin masa që:
 - Në çdo shkollë të sigurohen të paktën dy mjedise për shpërndarjen e librit shkollor nga shtëpitë botuese, librat e të cilave janë përzgjedhur nga shkolla dhe janë në Katalogun Altartekst 2010. Këto mjedise të funksionojnë për këtë qëllim, deri kur të përfundojë pajisja e të gjithë nxënësve me tekste shkollore.
 - Mësuesit e lëndëve i raportojnë drejtorisë së shkollës për furnizimin e nxënësve me tekste shkollore.
 - Drejtoritë e shkollave të kontrollojnë furnizimin e mjediseve të shkollave vetëm me librat sipas kërkesës së tyre. Drejtori i shkollës mban përgjegjësi për rastet e shitjes në mjediset e shkollës të librave pa hologramë dhe që nuk figurojnë në katalogun “Altartekst - 2010”.
 - Drejtoritë e shkollave të monitorojnë pajisjen e nxënësve me tekstet shkollore dhe të informojnë DAR/ZA-të për ecurinë e procesit.

- DAR/ZA-të të njoftojnë zyrtarisht Komisionin e Miratimit të Teksteve (KMT) në MASH për ecurinë e procesit të furnizimit të nxënësve me tekste shkollore si dhe problematikat e mundshme (mungesë tekstesh, shitje librash jashtë katalogut, shitje pa faturë etj.).
 - Drejtoritë e shkollave të fillojnë punën qysh në ditët e para të fillimit të vitit shkollor për zbatimin e Udhëzimit të përbashkët të MASH-it dhe Ministrisë së Financave Nr. 15, datë 28.05.2010 "Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar dhe universitar".
 Nxënësit e arsimit 9 vjeçar ose të mesëm, që plotësojnë këto kushtet e mëposhtme:

- kanë status ligjor të jetimit,
 - vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie nga zyrat e punësimit,
 - kryefamiljari përfiton pension invaliditeti dhe nuk ka anëtarë të punësuar ose të vetëpunësuar,
 - kryefamiljari përfiton pension pleqërie shteti dhe ka fëmijët në ngarkim, të cilët janë pa të ardhura,
 - vijnë nga familje që kanë në përbërje të tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose bërë të tillë dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik ose të vetëpunësuar në sektorin privat,
- pas blerjes së teksteve shkollore, dorëzojnë në drejtorinë e shkollës faturat/kuponin tatimor të blerjes. Drejtoria e shkollës, për nxënësit që plotësojnë kushtet e mësipërme, si dhe për nxënësit e minoritetit grek ose maqedonas, mbështetur në dokumentacionin që vërteton statusin/gjendjen sipas vendimeve të njëjësive të pushtetit vendor për gjendjen ekonomike/familjare, harton listat për çdo klasë dhe për të gjithë shkollën dhe brenda datës 15.10.2010 i dërgon në DAR/ZA.
- Nxënësve të arsimit 9-vjeçar, që vijnë nga familje ku kryefamiljari është i punësuar në institucione publike buxhetore dhe jobuxhetore të pushtetit qendror apo vendor, si dhe në shoqëritë me kapital shtetëror, me pagë mujore bruto deri në 30 000 lekë në muaj dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik ose të vetëpunësuar në sektorin privat, çmimi i blerjes së teksteve shkollore u mbulohet nga buxheti i vetë institucionit apo shoqërisë në masën 50 për qind. Pra, kjo kategori nxënësish faturat tatimore nuk i dorëzon në shkollë, po në qendren e punës të kryefamiljarit.

Struktura mësimore për vitin shkollor 2010-2011 në sistemin parauniversitar

Nxënësit tre periudha pushimesh.

**Ministria e Arsimit dhe e Shkencës njofton të gjithë nxënësit, mësuesit dhe prindërit,
se viti shkollor 2010-2011 do të nisë më datë 6 shtator 2010.**

**Për shkollat 9-vjeçare të sistemit arsimor parauniversitar, semestri i parë do të nisë më 6 shtator 2010
dhe do të përfundojë më 28 janar 2011, ndërsa semestri i dytë do të fillojë më 31 janar
të vitit 2011 dhe do të mbarojë më 10 qershor.**

**MASH njofton se gjatë gjithë vitit shkollor do të ketë disa periudha pushimesh
si për nxënësit ashtu edhe për mësuesit.**

Periudha e parë e pushimeve do të jetë nga data 27 tetor 2010 deri më 31 tetor 2010.

**Më pas pushimet e fundvitit do të nisin më datë 24 dhjetor 2010 dhe do të mbarojnë
më datë 5 janar 2011.**

**Gjatë vitit shkollor do të ketë edhe një periudhë të tretë pushimesh që do të nisë
më 28 mars 2011 dhe do të mbarojë më 3 prill.**

**Për të gjithë sistemin e arsimit bazë parauniversitar në Shqipëri viti shkollor do të përfundojë më datë
10 qershor të vitit 2011. Klasat e nënta të këtij sistemi do të zhvillojnë provimet
e lirimt gjatë periudhës 15-30 qershor të vitit 2011.**

**Për shkollat e mesme, viti shkollor do të nisë më 6 shtator dhe do të mbarojë më 17 qershor, ndërsa
vetëm për klasat e 12 mësimi përfundon më 24 maj të vitit 2011.**

**Pushimet do të jenë në të njëjtat data me të gjithë sistemin parauniversitar, ndërsa klasat
e 12-ta do të kenë sesionin e provimeve të detyruara të Maturës Shtetërore
nga periudha 26 maj-30 qershor 2011.**

**Ministria e Arsimit dhe Shkencës vlerëson se pushimet që janë caktuar për vitin e ri shkollor
do të vlejnë për nxënësit për t'u dhënë hapësirë, ndërsa për mësuesit do të shërbejë
si një periudhë e kualifikimit të vazhduar.**

**MASH njofton gjithashtu se kjo strukturë është shpërndarë në bazë të një udhëzimi të gjitha Drejtorive
Arsimore dhe Zyrave Rajonale në vend dhe do të keni mundësi t'i gjeni lehtësisht
jo vetëm në web-site zyrtar të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, por edhe të afishuara
në të gjitha shkollat e vendit.**

Revista “Mësuesi” shpall fushatën për çmimet:

Mësuesi Model 2010-2011

Fotografia më e mirë 2010-2011

“Mësuesi Model 2010-2011” do të jetë ai/ajo që punon përditë,
me profesionalizëm, karakter e përkushtim.

“Fotografia më e mirë 2010-2011” do të jetë ajo
që pasqyron arsimin shqiptar në shekullin e ri.

“

*Thuaj Faleminderit, propozoje për çmimin e madh,
mësuesin që ju frymëzon e drejton
për një jetë më të mirë e me dinjitet.*

*Dërgoni në redaksi fotografi që tregojnë kapërcim sfidash,
humanizëm dhe vizion për arsimin
shqiptar në shekullin e 21 ”*

Si mund të kontaktoni me ne:



Nina Gjoçi:
ngjoci@mash.gov.al;
cel. 068 4078913



Vjollca Spaho:
vspaho@mash.gov.al;
cel. 069 5376532



Andon Andoni:
aandoni@mash.gov.al;
cel. 068 2246227

Adresa e redaksisë: Rruga e Durrësit (pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës), nr. 23 - Tiranë
tel. 04 2227206 - revistamesuesi@mash.gov.al

U shtyp në shtypshkronjën “ALBDESIGN” - Autostrada Tiranë-Durrës km. 5 - www.alb-design.net

Çmimi 100 lekë